



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë/Ministarstvo Pravde/Ministry of Justice

STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE
DHE DHUNA NDAJ GRAVE 2022 – 2026

Janar 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
I. HYRJA	9
II. METODOLOGJIA	10
III. SFONDI	13
IV. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË	37
<i>IV.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK I</i>	38
<i>IV.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK II</i>	41
<i>IV.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK III</i>	44
<i>IV.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK IV</i>	47
V. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË	53
VI. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE 2022 – 2026	55

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AD	Akademia e Drejtësisë
ANJF	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
DHnG	Dhuna ndaj Grave
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
IAPK	Instituti i Avokatit të Popullit të Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKDN	Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KE	Këshilli i Evropës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
LGBTI	Lesbikë, Gej, Biseksual, Transgjinnor dhe Interseks
LMDHF	Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimi Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPBAP	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PK	Policia e Kosovës
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
QAP	Qendra e Aftësisimit Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRP	Qendra Rajonale e Punësimit
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
UM	Urdhër i Mbrojtjes
UME	Urdhër i Mbrojtjes Emergjente
UMPE	Urdhër për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave është ndër format më të përhapura të dhunës dhe shkelje e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e amenduar në vitin 2020, i njej zbatim të drejtëpërdrejtë Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (“Konventa e Stambollit”), një instrument për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe për mbrojtjen e viktimave. Mbrojtja e jetës dhe të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë, garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, gjen rregullim edhe në kuadër të Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës e parasheh si vepër penale të posaçme dhunën në familje dhe njej si dhunë në familje këto forma dhune: dhunën fizike, psikologjike, ekonomike dhe seksuale brenda një marrëdhënieje familjare. Konventa e Stambollit e përkufizon “dhunën ndaj grave” si “...shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private...”¹ Ndërsa “dhuna në familje” përkufizohet si “...të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën...”² dhe “dhuna gjinore kundër grave” si “... dhunë që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale...”³

Dhuna ndaj grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e plotë të grave. Ajo përbën një prej mekanizmave thelbësorë socialë me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat. Gratë dhe vajzat janë shpesh të ekspozuara ndaj dhunës, si për shembull dhuna në familje, ngacmimi seksual, dhunimi, martesë e detyruar, trafikimi, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit “nder” dhe gjymtimi i organeve gjenitale, që përbëjnë vepër penale, duke u shndërruar në pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave. Realizimi i barazisë de jure dhe de facto midis burrave dhe grave është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave.

Gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat dhe djemtë ndaj një rreziku më të lartë të dhunës në baza gjinore. Megjithatë, edhe pse dhuna në familje prek gratë në mënyrë

¹ Neni 3/a i Konventës së Stambollit. Shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>.

² Po aty pika b.

³ Po aty pika d.

disproporcionale, burrat gjithashtu janë viktime të dhunës në familje⁴, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, e po ashtu është fakt që fëmijët vajza dhe djem janë viktime të dhunës në familje, përfshirë rastet si dëshmitarë të kësaj forme të dhunës. Dhuna në familje ndaj fëmijëve është e përhapur dhe studimet kanë zbuluar lidhjen midis dhunës në familje ndaj grave dhe abuzimit fizik të fëmijëve, si dhe traumave që dëshmimi i dhunës në shtëpi shkakton te fëmijët.⁵

Dhuna në familje në Republikën e Kosovës mbetet një ndër problemet më serioze me të cilat përballet shoqëria. Raporte të ndryshme, kombëtare dhe ndërkombëtare konstatojnë praninë e dhunës në familje, si dhe pranueshmërinë e përdorimit të dhunës si mjet disiplinimi dhe edukimi, duke e pranuar nënshtrimin të “autoriteti”. Anketa e botuar në vitin 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) me të dhëna të mbledhura gjatë vitit 2018, zbuloi se 57% e grave të anketuara në Republikën e Kosovës kishin pësuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale që nga moshën 15 vjeç (më specifikisht, 53% e grave kishin pësuar dhunë psikologjike, 9% dhunë fizike dhe 4% dhunë seksuale nga partneri intim). Shumë gra në Kosovë (48%) ende e konsideronin një dhunë të tillë, veçanërisht dhunën në familje, një çështje private, që shpesh vazhdon të fshihet, pa u raportuar kurrë.⁶ Studimi i OSBE-së zbuloi se gratë të cilat kishin nivele më të ulëta arsimimi, ishin të varura financiarisht ose ato të cilat jetonin në zona rurale, kishin më shumë gjasa të deklaronin se kishin përjetuar dhunë në familje. Ndërsa Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, e kryer në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS, evidentoi, ndër të tjera se në grupmoshën 15-49 vjeçare, 25% vajza/të reja/gra dhe 57% vajza/të reja/gra të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe 12% djem/të rinj/burra dhe 26% djem/të rinj/burra të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, e arsyetojnë dhunën fizike ndaj bashkëshortes për një rën nga arsyet në vijim: largohet nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin⁷. Studime të tjera të realizuara nga organizata të shoqërisë civile, evidentojnë se në Kosovë, në vitet e fundit, ka një vëmendje të shtuar i është drejtuar femicidit në kontekstin e dhunës në familje, për vetë faktin se nga viti 2017 deri në vitin 2020, të paktën 74 gra janë vrarë.⁸ 62% e kosovareve dhe kosovarëve kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre. 21% e kosovareve dhe kosovarëve mendojnë se "Najherë osht' në rregull që një burrë me goditë grun e tij".⁹ Gjithashtu në këto studime evidentohet se në përgjithësi, ka përmirësime në njohuritë dhe qëndrimet e institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave

⁴ Konventa e Stambollit njeh faktin që edhe pse shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra, burrat gjithashtu mund të jenë viktime të dhunës në familje.

⁵ Raporti Shpjegues mbi “Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje” CET/210, 11.05.2011, fq.1 paragrafi 4. Shiko: <https://rm.coe.int/16800d383a>.

⁶ Një anketë për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë”, OSBE 2019. Shiko: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>.

⁷ Shiko: <https://mics.unicef.org/surveys>.

⁸ Të dhënat e paraqitura në raportin e përgatitur nga Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>.

⁹ Të dhëna nga publikimi i Rrjetit të Grave Kosovë “Dhuna nuk fshehet mrena mureve”, Korrik 2019. Shiko: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/07/BOOKLET_SHQIP.pdf.

me bazë gjinore krahasuar me vitin 2017. Megjithatë, ekziston kuptimi i pamjaftueshëm i formave të ndryshme të dhunës ndaj grave, dhunës me bazë gjinore, veçanërisht për dhunën seksuale. Fajësimi i viktimës vazhdon. Përpjekjet për të “pajtuar” çiftin “për të ruajtur familjen” dhe shkeljet e konfidencialitetit mbeten mbizotëruese në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Kjo gjendje e papranueshme kërkon një përgjigje sistematike dhe të koordinuar nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës përmes ndërtimit të politikave në fushën e parandalimit, mbrojtjes, riintegritimit dhe fuqizimit të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe të ndëshkimit e rehabilitimit përmes trajtimit psiko-social të kryerësve të këtyre formave të dhunës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në programin e saj katër vjeçar e ka vënë në prioritet luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Në fushëveprimin e saj, Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar parandalimin dhe adresimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave si një nga pesë objektivat strategjike. Si rrjedhojë, janë parashikuar politika kombëtare për përmirësimin e kuadrit ligjor, zbatimit të kwtij kuadri, dhe ndërmarrja e nismës së hartimit të kësaj Strategjie dhe Plani të Veprimit.

Kjo Strategji Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026¹⁰, si dhe Plani i saj i Veprimit, u përgatitën në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (GZ nr.7 / 01 mars 2019); nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të rregullores (QRK)- NR 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), nenit 11 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 7/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 4/83 datë 11.07.2012. Grupi Punues i mbledhur në bazë të Vendimit Nr. 99, datë 11.06.2021 të Ministres së Drejtësisë për këtë qëllim, drejtohej nga Koordinatorja Nacionale kundër dhunës në familje dhe përbëhej nga 21 anëtarë, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse.

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me Strategjinë e mëparshme Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në familje dhe Planin e saj të Veprimit 2016 – 2020, kjo Strategji përmban veprime dhe masa që synojnë të avancojnë më tej arritjet nga vlerësimi i zbatimit të strategjisë së mëparshme, por edhe sigurojnë mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave në përputhje dhe sipas standardeve të instrumentave ndërkombëtarë të ratifikuar. Këtu një vend të rëndësishëm zë Konventa e Stambollit. Kjo Konventë u bë pjesë e Kushtetutës së Republikës

¹⁰ Në ndryshim nga Strategjia e mëparshme për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016 - 2020, në këtë Strategji është shtuar edhe koncepti i “dhunës ndaj grave”, në të gjithë tekstin dhe veprimet e parashikuara, në përputhje dhe harmonizim me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Prandaj emërtimi i dokumentit të përgatitur është: “Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026”.

së Kosovës me një amendament në 25 shtator 2020¹¹. Prandaj edhe veprimet e parashikuara në Planin e Veprimit të zbatimit të Strategjisë 2022-2026 mbështetin fuqishëm zbatimin e neneve dhe parashikimeve e standardeve të kësaj Konvente.

Në përputhje me Konventën e Stambollit në këtë Strategji do të trajtohet dhuna në familje (sipas përkufizimit në nenin 3, pra dhuna fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike), si dhe: dhuna psikologjike (neni 33), sjelljet kërcënuese/përndjekja (neni 34), dhuna fizike (neni 35), dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin (neni 36), martesë e detyruar (neni 37), gjymtimi i organeve gjinitale femërore (neni 38), aborti dhe sterilizimi i detyruar (neni 39), si dhe ngacmimi seksual (neni 40).

Siç udhëzohet edhe në veprimet që duhet të ndërmerren shtetet palë, të cilat kanë nënshkruar e ratifikuar Konventën e Stambollit, për një zbatim sa më efektiv të saj duhet të ndërmerren veprime e masa të cilat të përputhen me shtyllat e Konventës: Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja Penale dhe Politika të Intergruara¹². Veprimet dhe masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 - 2026, bazohen në ato të parashikuara nga Konventa si detyrim për shtetet palë dhe për lehtësi, organizohen në katër shtylla kryesore:

- I. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës.
- II. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare.
- III. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave.
- IV. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, ka në themel të saj vizionin:

Një shoqëri ku të gjithë janë të sigurt dhe të barabartë, jetojnë pa frikën apo kërcënimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ku qëllim është të parandalohet dhe mos tolerohet dhuna, të mbrohet, riintegrohet dhe fuqizohet viktimat, si dhe të vendoset kryerësi para përgjegjësisë.

Ky vizion zërthehet më tej në deklaratën e misionit të paraqitur në vijim.

Deri në vitin 2026, Qeveria e Kosovës së bashku me institucionet përgjegjëse dhe palët mbështetëse do të:

- marrin përgjegjësi për trajtimin me prioritet të të gjithë rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- sigurojnë burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për të luftuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave;
- sigurojnë qasje në shërbime cilësore të integruara;

¹¹ Këshilli i Evropës, “Kuvendi Kombëtar i Kosovës* vendos të zbatojë Konventën e Stambollit”, 2020. Shiko: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/the-national-assembly-of-kosovo-decides-to-apply-the-istanbul-convention>

¹² Shiko: <https://rm.coe.int/168064d3f6>

- garantojnë drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarat;
- sigurojnë riintegrim dhe fuqizim të viktimave /të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- ndëshkojnë, risocializojnë dhe rehabilitojnë kryerësit e dhunës;
- rrisin vetëdijesimin e mbarë shoqërisë kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Për të përmbushur me sukses këtë mision dhe për të avancuar drejt vizionit të kësaj Strategjie janë parashikuar ndërhyrjet sipas katër objektivave strategjike, objektivave specifike në të cilët ata zërthehen, si dhe veprimeve kryesore që parashikohen të ndërmerren. Këto sqarohen më në detaje në kapitullin V të këtij dokumenti.

Të gjitha sa më sipër, së bashku me aktivitetet dhe treguesit përkatës të matjes së ecurisë së zbatimit të kësaj strategjie, burimet financiare që duhet të vihen në dispozicion, institucionet bartëse dhe partnere, si dhe produktet e referenca në dokumente të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë, paraqiten të plotë në matricën e planit të veprimit, në kapitullin VIII të këtij dokumenti.

I. HYRJA

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave dhe Planit të saj të Veprimit për periudhën 2022 - 2026 bazohet në Programin e Qeverisë së Kosovës¹³/Planin Strategjik Operacional të Ministrisë së Drejtësisë 2021-2025, ku një ndër pesë prioritetet kyçe është **“Parandalimi dhe adresimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore”** që si aktivitet të veçantë parasheh hartimin e kësaj Strategjie dhe Planit të Veprimit. Gjithashtu, Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026¹⁴ rekomandon si të domosdoshme ndërmarrjen e nismave për adresimin e dhunës në familje.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, synon që të rrisë përpjekjen për të garantuar të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë. Kjo e drejtë themelore synohet të arrihet përmes aktiviteteve të parashikuara me këtë Strategji në fushën e parandalimit, mbrojtjes, riintegritit dhe fuqizimit të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ndëshkimit dhe rehabilitimit të kryerësve të këtyre formave të dhunës, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe ndërveprimit institucional.

¹³ Shiko: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

¹⁴ Miratuar në 11.08.2021. Shiko: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>

II. METODOLOGJIA

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 dhe plani i saj i veprimit u hartuan bazuar në Vendimin Nr. 99, datë 11. 06.2021, të Ministres së Drejtësisë. Kjo Strategji dhe plani i saj i veprimit, u përgatitën në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (GZ Nr.7 / 01 mars 2019); nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të rregullores (QRK)- NR. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), nenit 11 dhe 13 të Udhëzimit Administrativ Nr. 7/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, si dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 4/83 datë 11.07.2012.

Grupi Punues i themeluar dhe mbledhur për këtë qëllim, drejtohet nga Koordinatorja Nacionale kundër dhunës në familje dhe përbëhet nga 21 anëtarë e përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, si më poshtë:

- 1.1 **Nita Shala**, Koordinatore Nacionale kundër Dhunës në Familje, Zëvendësministre e Drejtësisë, Kryesuese;
- 1.2 **Edi Gusia**, Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit, Zëvendës-kryesuese;
- 1.3 **Nazlie Bala**, Kabineti i Ministres të Drejtësisë, anëtare;
- 1.4 **Vedat Sogojeva**, Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministrit, anëtar;
- 1.5 **Florentina Beqiraj**, Njësia për të Drejtat e Njeriut, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 1.6 **Selvije Elezaj**, Divizioni për Koordinim të Politikave, DIEKP, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 1.7 **Albulena Uka**, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 1.8 **Adile Shaqiri**, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtare;
- 1.9 **Azize Daku**, Ministria e Shëndetësisë, anëtare;
- 1.10 **Lorik Lipoveci**, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
- 1.11 **Merita Jonuzi**, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtare;
- 1.12 **Gëzim Bislimi**, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
- 1.13 **Dorotea Deshishku**, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtare;
- 1.14 **Fatime Dermaku**, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtare;
- 1.15 **Luljeta Hetemi**, Akademia e Drejtësisë, anëtare;
- 1.16 **Ilirjana Collaku Tafa**, Këshilli Prokurorial i Kosovës, anëtare;
- 1.17 **Arsim Shala**, Policia e Kosovës, anëtar;
- 1.18 **Basri Kastrati**, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, PSH, anëtar;
- 1.19 **Nazife Jonuzi**, Koalicioni i Strehimoreve, anëtare;
- 1.20 **Fjolla Sojeva**, Divizioni për Buxhet dhe Financa, Ministria e Drejtësisë, anëtare;
- 1.21 **Luljeta Ibishi Ferizi**, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtare.

Puna e Grupit Punues në hartim të Strategjisë është mbështetur edhe nga zyra e UN Women në Kosovë, me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të programit rajonal për eliminimin e dhunës ndaj grave ‘Implementimi i normave, ndryshimi i mendësisë’, dhe dy ekspertëve të angazhuar Monika Kocaqi dhe Donat Rexha.

Strategjia dhe Plani i Veprimit u hartuan përmes një metodologjie të kombinuar, ku kërkimet mbi raportet dhe studimet ekzistuese u plotësuan më tej me të dhënat e përditësuara të vëna në dispozicion nga përfaqësuesit e institucioneve anëtarë të Grupit Punues për përgatitjen e kësaj strategjie.

Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë së mëparshme Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 shërbyen gjithashtu si një burim i mirë informacioni, sidomos në dakordësimin për veprime të parashkuara dhe të pa zbatuara në atë strategji, të cilat u konsideruan si relevante për t'u bartur në strategjinë e re.

Pas analizës së shkurtër të gjendjes aktuale, janë përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet dhe veprimet konkrete, të cilat janë kostuar. Plani i Veprimit në aspektin strukturor është hartuar në përputhje me udhëzimin administrativ të Zyrës për Planifikim Strategjik (ZPS) dhe nën-udhëzimet e vazhdueshme të kësaj zyre, përmes përfaqësuesit të kësaj zyre në Grupin Punues.

Procesi i hartimit të Strategjisë u zhvillua në tri faza:

- I) faza e parë, u karakterizua me analizimin e situatës së përgjithshme, si dhe realizimin e një seri të takimeve konsultative, në të cilat kanë qenë të përfshirë institucionet përgjegjëse dhe aktorët relevantë të cilët punojnë në nivel qendror e lokal;
- II) përgjatë fazës së dytë, Grupi Punues përgjegjës për hartimin e Strategjisë ka analizuar dokumentet strategjike në fuqi, raporte e vlerësime të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, veçanërisht raportet e monitorimit të zbatimit të “Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”¹⁵, Programin Qeverisës së Republikës së Kosovës 2021–2025¹⁶, Konventën e Stambollit¹⁷, Konventën e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave (CEDAW)¹⁸, Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim¹⁹, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Axhendën 2030²⁰, si dhe strategji të tjera sektoriale. Në bazë të kësaj analize të detajuar u përcaktuan edhe objektivat strategjike dhe specifike, përmbushja e të cilëve do të kontribuojë në arritjen e synimeve kombëtare të përcaktuara sipas qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm në Kosovë (SDGs), etj.

¹⁵ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit i Veprimit 2016 – 2020”, maj 2016, shiko: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/52BA49FC-80C2-4172-A2F7-9E83D078F3E7.pdf>.

¹⁶ Programi Qeverisës i Republikës së Kosovës 2021–2025, maj 2021. Shiko: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>.

¹⁷ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe Luftimin Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>

¹⁸ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, shiko: <https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAW-a.pdf>.

¹⁹ Shiko: https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/swd_2020_284_en_final.pdf.

²⁰ Shiko: <https://sdgs.un.org/goals> dhe <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>.

III) Ndërsa, në fazën e tretë, dokumenti iu nënshtrua procesit të konsultimeve paraprake dhe publike. Për më shumë, dokumenti iu nënshtrua një procesi të gjërë konsultimesh të posaçme me të gjitha palët e interesit, përkatësisht 11 konsultime me mbi 200 akterë, duke synuar identifikimin dhe adresimin e të gjitha çështjeve që lidhen me palët specifike. Këto takime janë zhvilluar përgjatë tërë fazës së konsultimeve paraprake dhe publike. Grupi Punues ndërinstitucional ka shqyrtuar dhe inkorporuar inputet e pranuar nga këto konsultime dhe sipas kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2012 është proceduar për aprovim.

Versioni përfundimtar i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 dhe Plani i saj i Veprimit, u dërgua për miratim në Qeverinë e Kosovës, në Janar 2022.

III. SFONDI

Dhuna në familje është problem mbarë botëror dhe mbetet ndër format më të përhapura të dhunës që shpesh vazhdon të cilësohet edhe si “çështje e dyerve të mbyllura”. Dhuna ndaj grave e vajzave merr trajta e përmasa të ndryshme dhe jo në pak raste justifikohet gjithashtu edhe nën pretekstin e “kodit të nderit dhe turpit”.²¹

Kjo dhunë nënkupton çdo akt force që shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim fizik, psikologjik, ekonomik apo seksual. Ajo përfshin kërcënimet për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar nga liria që mund të ndodhë në jetën publike apo private. Ky përkufizim vlen, përveç të tjerave, edhe për dhunën që ndodh brenda familjes apo shtëpisë, përfshirë këtu agresionin fizik dhe mendor, abuzimin emocional dhe fizik, dhunën seksuale, incestin, krimet e ‘nderit’, gjymtimet seksuale dhe gjenitale dhe praktika të tjera të dëmshme për gratë, si psh. martesat e detyruara.²²

Një numër i konsiderueshëm grash janë viktima të dhunës në familje - abuzim i përsëritur i të gjitha formave që merr kjo dhunë, të cituara më sipër, që shkakton frikë, dëshpërim dhe shpesh dëmtim të shëndetit të gruas. Dhuna ndaj grave në familje është një goditje serioze ndaj dinjitetit njerëzor dhe shërben si pengesë që gratë të gëzojnë të drejtat e tyre themelore. Ky sulm ndaj dinjitetit njerëzor kryhet në kushtet e heshtjes, dhe ndonjëherë të indiferencës së përgjithshme, brenda shtëpive, në të gjithë Evropën. Dhuna ndaj grave në familje është rezultat i një situatë ku gratë kanë më pak pushtet se burrat, duke rezultuar në diskriminim serioz të grave dhe vajzave në familje dhe shoqëri. Megjithatë statistikat japin vetëm rastet e provuara të dhunës brenda familjes, përsëri shifrat janë shqetësuese. Ato konfirmojnë faktin se dhuna ndaj grave në familje, qoftë kjo fizike, seksuale, psikologjike ose si rrjedhojë e varësisë ekonomike, nuk njih dallime gjeografike, moshore, etnike dhe prek të gjitha llojet e marrëdhënieve familjare dhe mjedisi social. Dhuna në baza gjinore prek jo vetëm viktimat e drejtpërdrejta, por të gjithë komunitetin. Kosto e lartë e dhunës në baza gjinore është një barrë serioze për shoqërinë, qeveritë, individët, organizatat dhe bizneset - kjo është arsyeja se pse kjo dhunë i ka kaluar caqet e të qenit një problem privat dhe është kthyer në një problem publik, zgjidhja e të cilit përbën një nevojë urgjente²³.

Ngritja e vetëdijes për format e ndryshme të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është element i rëndësishëm në parandalimin e dhunës, sepse vetëdija e rritur është hapi i parë drejt ndryshimeve të qëndrimeve dhe sjelljeve që nxisin ose lejojnë forma të ndryshme të dhunës ndaj grave. Për këtë qëllim, Konventa e Stambollit kërkon që shtetet palë të ndërmarrin nisma

²¹ Ndërkohë që sipas Konventës së Stambollit, në nenin 12/5 theksohet se “...Palët garantojnë që kultura, zakonet, feja, tradita ose *ashtuquajtur* “nder” të mos konsiderohen si justifikim për çdo akt dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente...”.

²² Burimi: Shtojca e Rekomandimit Rec(2002)5 e Komiteti të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e grave nga dhuna. Shiko: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805e2612.

²³ Përshtatur nga: “Udhëzues për parlamentarët. Parlamentet e bashkuara për të luftuar dhunën ndaj grave”, përgatitur nga Sekretariati i Komitetit për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat/ Asambleja Parlamentare e Këshillit Të Evropës. Shiko: https://www.coe.int/t/pace/campaign/stopviolence/Source/handbook_al.pdf.

të gjera për vetëdijesim, si pjesë e një sërë masash që synojnë parandalimin e dhunës kundër grave.²⁴

Është shumë i rëndësishëm fakti që dhuna në familje të analizohet në kontekstin e traditave, kulturës dhe mentalitetit të një vendi. Nëse analizojmë se përse ndodh dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, evidentojmë një gërshetim të disa faktorëve nxitës dhe faktorëve të riskut të lidhur me karakteristika individuale të personit që e ushtron dhunën apo që e përjeton atë, me faktorë nxitës dhe faktorë të riskut të lidhur me atmosferën e përgjithshme, siç janë sjelljet dhe mentalitetet e përpunuara nga shoqëria. Ndër karakteristikat individuale të personit faktorë nxitës identifikohen të jenë: alkoolizmi, xhelozia, papunësia, varfëria, stresi, impotenca seksuale, komplekse të ndryshme inferioriteti brenda çiftit, konkurrenca intelektuale, profesionale dhe arsimore brenda çiftit, paaftësia profesionale, shtatzënia e padëshiruar, të qenit dëshmitar i dhunës apo i dhunuar gjatë fëmijërisë, probleme të shëndetit mendor, etj. Megjithatë këto karakteristika individuale ndikojnë në shpeshhtësinë e ushtrimit të dhunës dhe në përshkallëzimin e saj, nuk janë shkaktarët e vetëm të dhunës. Rrënjët e dhunës qëndrojnë në mentalitetin patriarkal dhe efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore që vazhdojnë të mbahen gjallë nga shoqëria. Këtu ndikojnë një sërë faktorësh të tjerë nxitës si: mendësia dhe tradita kulturore i rezervon gruas një pozicion inferior në krahasim me burrin; mangësitë në legjislacion dhe moszbatimi i ligjeve ekzistuese, nuk arrijnë t'i mbrojnë gratë brenda dhe jashtë mureve të shtëpisë; kushtet ekonomiko-shoqërore të grave janë të pabarabarta dhe në nivele më të ulëta në krahasim me ato të burrave, sepse ka varësi më të thellë ekonomike të grave, që do të thotë më pak shanse për jetë të pavarur ekonomike dhe shoqërore; numri i ulët i pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje; niveli i lartë i papunësisë, veçanërisht mes grave; përfshirja e burrave në aktivitete kriminale që rrisin stresin e përditshëm dhe i bëjnë gratë objekt të shkarkimit të këtij stresi; përfshirja e burrave në aktivitete të lojërave të fatit; rritja e numrit të njerëzve që kanë mendimin e të bërit të pasur në një kohë të shpejtë, etj.

Në Kosovë, ashtu si në rajon dhe në botë, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë prezente dhe përbëjnë një shqetësim mbarëshoqëror. Rrënjët e këtyre formave të dhunës ushqehen nga pabarazitë gjinore dhe strukturore, të reflektuara në: pjesëmarrjen politike dhe ekonomike; qasjen në pasuri, të ardhura dhe shërbime; pjesëmarrjen në ekonomi; si dhe në standardet dhe cilësinë e jetës. Gratë nuk marrin pjesë në baza të barabarta me burrat në vendim-marrje, në punësim, në ekonomi, e shumë fusha të tjera. Ato nuk kanë të njëjtën qasje si edhe burrat në tregun e punës, në shërbimet mbështetëse, në kredi, etj.

Sipas të dhënave nga Policia e Kosovës, për vitin 2019 janë trajtuar 1915 raste të dhunës në familje me 1978 viktima (nga të cilat 1593 femra) dhe 26 viktima i përkasin grupmoshës 0-18 vjeçare. Për vitin 2020 janë trajtuar 2069 raste të dhunës në familje me 2101 viktima (nga të cilat 1636 femra) dhe 121 viktima i përkasin grupmoshës 0-18 vjeçare. Për gjashtëmujorin e

²⁴ Neni 13 i Konventës së Stambollit. Shiko edhe: <https://rm.coe.int/article-13-of-the-istanbul-convention-albanian-/168097f2e5>.

parë të vitit 2021 (Janar – Qershor), janë trajtuar gjithsej 1122 raste të dhunës në familje me 1137 viktima (nga të cilat 878 femra) dhe 85 viktima i përkasin grupmoshës 0-18 vjeçare.²⁵

Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave ka trajtuar për vitin 2019 gjithsej 1353 raste të dhunës në familje, për vitin 2020 ka trajtuar 1524 raste të dhunës në familje dhe për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 ka trajtuar 844 raste të dhunës në familje.²⁶

Zyrat mobile për Ndhimë Juridike Falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 15 komuna për vitin 2021 dhe 1039 persona kanë kërkuar ndihmë juridike falas në këto zyra gjatë këtij viti. Për vitin 2020, zyrat mobile për ndihmë juridike falas ishin themeluar në 12 komuna dhe 1803 persona patën kërkuar ndihmë juridike falas në këto zyra gjatë këtij viti. Në vitin 2019 zyrat mobile për ndihmë juridike falas rezultojnë në 13 komuna dhe 1679 persona patën kërkuar ndihmë juridike falas gjatë atij viti.²⁷

Gjatë vitit 2018, një anketë mblodhi e përpunoi një sërë të dhënash të cilat më pas u publikuan në vitin 2019 nën “Anketën për Sigurinë dhe Mirëqenien e Grave në Kosovë”.²⁸ Sipas kësaj ankete:

- Mbi gjysma (ose 54%) e të gjitha grave thonë se kanë përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga një partner i ngushtë që nga moshja 15 vjeçare, dhe gati tre në dhjetë gra (ose 29%) thonë të kenë përjetuar ngacmime seksuale.
- Një në shtatë gra (ose 14%) pohojnë të kenë përjetuar dhunë fizike ose seksuale nga një partner ose jo partner (këtu nuk përfshihet dhuna psikologjike).
- Gratë të cilat morën pjesë në anketë dhe në hulumtimin cilësor kanë shprehur shqetësimin e tyre sa i përket dhunës ndaj grave në Kosovë. Gati dy të tretat e grave të anketuara (ose 64%) thonë se dhuna ndaj grave ndodh shpesh. Kështu, më se gjysma e grave (ose 54%) deklarohen të kenë përjetuar dhunë nga partneri intim, dhe kryesisht dhunë psikologjike, porse 9% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar po ashtu edhe dhunë fizike.
- Normat dhe qëndrimet shoqërore sa i përket rolit që duhet të kenë gratë në shoqëri dhe pranimi i gjerësishtëm i pabarazisë gjinore vendosin kontekstin për këtë dhunë. Ato ngulitin edhe më shumë pabarazinë në shoqëri ku burrat dominojnë në shtëpi, në punë dhe në sferën publike. Më se gjysma (ose 57%) e grave të moshës 18-74 vjeçare në Kosovë besojnë se rrethi i tyre shoqëror mendon se: “Një grua e mirë i bindet burrit të saj edhe nëse ajo ka tjetër mendim”.
- Një e katërta (ose 26%) e grave besojnë se rrethi i tyre shoqëror mendon se: "Gruaja e ka për obligim të kryejë marrëdhënie seksuale me burrin e saj edhe nëse ajo nuk ka dëshirë".
- Më se një e treta e grave (ose 35%) pajtohen me mendimin se dhunën e provokon viktima dhe gratë ekzagjerojnë pretendimet mbi përdhunim apo abuzim (32%).
- Përkundër përqindjes së lartë të grave të cilat kanë shpalosur të kenë qenë pre e dhunës së ushtruar nga partneri aktual apo ai i mëparshëm, shumica e grave nuk kanë kontaktuar asnjë

²⁵ Për të dhëna më të detajuara lutemi referohuni tek shtojca 1 në këtë Strategji.

²⁶ Për të dhëna më të detajuara lutemi referohuni tek shtojca 2 në këtë Strategji.

²⁷ Të dhënat të vëna në dispozicion nga MAPL, në kuadër të hartimit të kësaj strategjie, shtator 2021.

²⁸ Anketa e Zhvilluar nga OSBE Kosovë, 2019. Shiko: <https://www.osce.org/files/f/documents/e/4/439790.pdf>.

shërbim qoftë edhe në rastet më serioze të dhunës të ushtruar nga partneri aktual (92%), partner i mëparshëm (81%) ose jo partneri (72%).

- Në veçanti, vetëm 2% e grave raportuan për incidentin më serioz të dhunës së ushtruar nga partneri aktual në polici dhe 3% tek shërbimet sociale dhe gati asnjë nuk raportoi se kishte kontaktuar me ndonjë nga strehimoret për gratë apo me ndonjë shërbim tjetër të specializuar.
- E njëjta gjë vërtetohet dhe nga fakti se pothuajse gjysma e grave të anketuara (ose 48%) besojnë se dhuna në familje është "çështje private" që duhet mbajtur si e tillë brenda familjes.
- Gati një në pesë gra (ose 18%) të cilat kanë pasur partner më parë thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i mëparshëm, krahasuar me 9% të tyre që aktualisht kanë partner e të cilat thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga parterët aktualë. 8% e grave të anketuara thonë të kenë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga personat të cilët nuk i kanë partnerë.
- Përndjekja ka prekur një në dymbëdhjetë gra (ose 8%).
- Gati tri në dhjetë gra (ose 29%) të moshave 18-74 vjeç kanë përjetuar ngacmim seksual që në moshën 15 vjeçare.

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë e kryer në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS²⁹, evidentoi, ndër të tjera se:

- në grup-moshën 15-49 vjeçare, 25% vajza/të reja/gra dhe 57% vajza/të reja/gra të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian si dhe 12% djem/të rinj/burra dhe 26% djem/të rinj/burra të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, e arsyetojnë dhunën fizike ndaj bashkëshortes për njërën nga arsyet në vijim: largohet nga shtëpia pa i treguar; i neglizhon fëmijët; refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të; e djeg ushqimin.
- 1 në 3 gra të reja të moshës 20-24 vjeç të cilat jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian ishin të martuara ose në bashkëjetesë para moshës 18 vjeçare;
- vetëm 1 në 4 adoleshente/adoleshentë të moshës 10-14 vjeç në Kosovë disiplinohen me metoda jo të dhunshme;
- rreth 1 në 10 vajza/të reja të moshës 15-19 vjeç në popullatën e përgjithshme dhe ato që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian raportuan se kishin përjetuar diskriminim dhe ngacmim në baza gjinore;
- 1 në 8 vajza/të reja dhe 1 në 6 djem/të rinj të moshës 15-19 vjeç të cilat/cilët jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian përjetuan diskriminim dhe ngacmim bazuar në përkatësinë etnike ose origjinën e imigrimit.

Pabarazitë gjinore janë të rrënjosura në normat patriarkale. Një studim i vitit 2018 në Kosovë tregoi se qëndrimet tradicionale ende mbizotërojnë. Gati shtatë nga dhjetë burra pjesë e studimit (69.5%) u pajtuan që burri "duhet të ketë fjalën e fundit në lidhje me vendimet në

²⁹ Me mbështetjen e UNICEF. Shiko: <https://mics.unicef.org/surveys>.

shtëpinë e tij". Një përqindje e ngjashme (72.8%) besojnë se roli më i rëndësishëm i një gruaje është të kujdeset për shtëpinë dhe familjen e saj dhe 72.5% e burrave besojnë se një grua duhet të kujdeset për fëmijët e saj. Siç raportohet nga burrat, ndarja e detyrave shtëpiake bëhet sipas gjinisë, ku gratë kryejnë detyra që kryhen tradicionalisht nga gratë në shumicën e rasteve, siç është larja e rrobave (kryer në 88% të rasteve nga gratë), gatimi (80 % gratë) dhe pastrim (71% gratë)³⁰.

Të dhëna mbi situatën dhe qëndrimet patriarkale e justifikuese ndaj dhunës në familje e dhunës ndaj grave identifikohen edhe në botimet e përgatitura organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Në një broshurë vetëdijesuese të publikuar në vitin 2019³¹ jepen të dhëna rreth situatës si dhe dëshmi të grave dhe vajzave të cilat kanë përjetuar dhunë në familje, ku:

- 21% e qytetarëve ende thonë se “Ndonjëherë është në rregull që një burrë me goditë gruan e tij”;
- Një në tre qytetarë ende mendojnë se: “Fëmija disiplinohet me shuplaka”;
- Një në katër qytetarë ende nuk janë të vetëdijshëm se “Nuk është arsyetim me rreh gruan veç pse je i papunë” ose që “Marrëdhënia seksuale me zor është dhunë, edhe nëse jeni të martuar”;
- 62% e qytetarëve kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre.

Aktualisht moshë minimale e martesës është 18 vjeç, megjithatë gjykatat mund të lejojnë që individët deri në 16 vjeç të martohen nëse arrijnë në përfundimin se personi ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikologjike. Vajzat e reja të martuara kanë pak fuqi në raport me bashkëshortët dhe vjehrrit e tyre, prandaj ato janë jashtëzakonisht të cenueshme ndaj dhunës në familje, abuzimit dhe braktisjes.

Njohja, pranimi dhe trajtimi me përparësi i rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, kërkon padyshim një vetëdijesim shumë më të madh të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve të Kosovës, si dhe të tërësisë së institucioneve përgjegjëse qendrore e lokale, për rreziqet, pasojat dhe kostot që i sjell vendit mungesa e një reagimi të tillë të mirëkoordinuar.

Veprimet e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës flasin për një përmirësim të kuadrit ligjor e të politikave për mbrojtje nga dhuna në familje e dhuna ndaj grave. Kështu për shembull vitet e fundit, Kodi Penal i Kosovës u ndryshua në vitin 2019, për të përfshirë veprat penale në përputhje me Konventën e Stambollit, të tilla si: dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe gjymtimin e organeve gjinitale të grave.³² Kodi Penal tashmë e njeh dhunën në familje si dhunë

³⁰ “Një këndvështrim i burrave mbi barazinë gjinore në Kosovë: Gjetjet kryesore nga Anketa Ndërkombëtare Burrat dhe Barazia Gjinore (IMAGES)” (Prishtinë, Misioni i OSBE-së, 2018). Shiko: <https://promundoglobal.org/wp-content/uploads/2018/07/IMAGES-Kosovo-English.pdf>.

³¹ Broshurë: “Dhuna nuk fshehet mrena mureve”, përgatitur nga Rrjeti i Grave Kosovë, korrik 2019. Shiko: https://womensnetwork.org/p-content/uploads/2019/07/BOOKLET_SHOIP.pdf.

³² Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2019. Shiko: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6A2D4377-6AE1-4530-909F-3FB2680CD1EC.pdf>

fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike ose keqtrajtim brenda një marrëdhënieje familjare.

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje përcakton në mënyrë të ngjashme këto lloje të dhunës. Ky ligj që prej vitit 2020 është në proces ndryshim-përmirësimi, për të përmbushur më mirë nevojat e identifikuar dhe për t'i harmonizuar ato me Konventën e Stambollit.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit për periudhën 2016-2020 u miratua në dhjetor 2016.³³ Objektivat strategjike të parashikuara në këtë strategji kombëtare synonin: (i) Zvogëlimin e qëndrimeve paragjyquese dhe sjelljeve që e mbështesin dhunën në familje, nëpërmjet informimit, edukimit, arsimimit dhe vetëdijësimit të vazhdueshëm të profesionistëve e profesionistëve, komuniteteve dhe mbarë shoqërisë; (ii) Sigurimin e mekanizmave institucionalë gjithëpërfshirës dhe efikas, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunimin e përgjegjshëm ndërinstytucional, mes palëve pjesëmarrëse në nivel qendror dhe lokal, për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre rasteve; (iii) Përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe rritjen e efikasitetit të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, me fokus në nevojat e viktimës, si dhe ndëshkimin adekuat të kryerësit; (iv) Mundësimin në tërë territorin e Kosovës, të qasjes në shërbime të reja dhe ekzistuese, efikase dhe të qëndrueshme për rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave, si dhe rehabilitimin e kryerësve të dhunës në familje.

Gjatë periudhës me të cilën përkonte kjo Strategji janë realizuar nga Ministria e Drejtësisë edhe dy raporte të monitorimit të zbatimit të saj (përkatësisht në vitin 2018 dhe në vitin 2019)³⁴. Në të dy raportet evidentohet si progresi në realizimin e një pjese të madhe të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit, ashtu edhe vështirësitë dhe sfidat e ndeshura, të cilat më së shumti, lidheshin me realizimin e aktiviteteve në vijim: (i) Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore dhe certifikimi i stafit profesional (si: mësimdhënës, drejtor, pedagog, psikolog, këshilli drejtues i shkollës, prindër, zyrtarë nga drejtorit komunale të arsimit) me fokus tek dhuna në familje, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara; (ii) Rishikimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, të Arsimit Parauniversitar, dhe përfshirja në të e informacioneve të standardizuara për dhunën në familje, si dhe dhënia e informacioneve për dhunën në familje, grupeve punuese për hartim të kurrikulave lëndore - kategorizuar sipas të gjitha grupeve, mbi të cilat mund të ushtrohet kjo dhunë, (gra, fëmijë, të moshuar, PAK, LGBT, komunitetet jo-shumicë, etj), llojeve të dhunës si dhe ku mund të bëhet lajmërimi për rastet e dhunës; (iii) Studime kombëtare periodike mbi fenomenin, përmasat, profilin e autorëve të dhunës në familje/viktimave të dhunës në familje, etj; (iv) Zhvillimi i buletineve statistikore vjetore mbi numrin e rasteve të raportuara dhe trajtuara në mënyrë multidisiplinare; (v) Krijimi i një nënkategorie për financimin e Zyrës për Barazi Gjinore në nivel komunal dhe mbështetjen e funksionimit të Mekanizmave Koordinues; (vi) Përfshirja e viktimave të dhunës në familje në programe arsimore ekzistuese për të rriturit; (vii) Hapja e një strehimoreje për djemtë dhe burrat viktimë të dhunës në familje; (viii) Trajnime për zyrtarët e punësimit, shëndetësisë, arsimin,

³³ Republika e Kosovës, Qeveria, Vendimi nr. 09/125, më datë 30 dhjetor 2016. Shiko: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_125-te_te_Qeverise.pdf.

³⁴ Vënë në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë Kosovë, në kuadër të punës për hartimin e kësaj strategjie.

shërbimeve sociale dhe të tjera për një qasje sensitive gjinore; (ix) Ngritja e qendrave të këshillimit për viktimat; (x) Fuqizimi ekonomik i viktimave me anë të subvencionimit nga ministritë përkatëse (p.sh. për viktimat e dhunës të cilat dëshirojnë të nisnin biznese të vogla, apo lirimi nga pagesat për ndjekjen e arsimit, etj); (xi) Futja e programeve të veçanta për viktimat e dhunës në familje, si nënkategori e vijës kryesore buxhetore të secilës ministri/institucion; (xii) Ofrimi i lehtësirave (pako Fiskale) për bizneset që punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje; (xiii) Angazhimi i Shërbimit Sprovues të Kosovës për përcjelljen e rehabilitimit dhe riintegrimin të kryesve.

Ndërsa nga një raport i publikuar në vitin 2021³⁵, nga një organizatë e shoqërisë civile, ku ndër të tjera jepet edhe progresi në zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, deri në fund të vitit 2020, rezultojnë si sfida dhe aktivitete të përcaktuara, sa në vijim:

- Përmirësimi i standardeve të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje;
- Krijimi i një nënkategorie për financimin e Zyrës për Barazi Gjinore në nivel komunal dhe mbështetjen e funksionimit të Mekanizmave Koordinues;
- Përshtatja e shërbimeve mbrojtëse, në mënyrë që të jenë të qasshme, edhe për grupet me nevoja të veçanta (të tillë siç janë personat me AK, LGBT, komunitetet jo-shumicë – ofrimi i shërbimit në gjuhën e tyre, etj), në përputhje dhe me standardet e përmirësuara dhe të miratuara bazuar në ato ndërkombëtare;
- Shtimi i burimeve dhe i stafit të Zyrës së Koordinatorit Nacional kundër dhunës në familje, të cilët në përshkrimin e tyre të punës duhet të kenë përgjegjësi specifike për mbështetjen e zbatimit dhe monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Caktimi i grupit punues të profesionistëve (përfshirë edhe OJQ-të me përvojë në punën me dhunën në familje) për harmonizimin e bazës ligjore me standardet ndërkombëtare dhe me studimet ekzistuese, si dhe për hartimin e udhëzuesit për politikën ndëshkimore, përfshirë dhe ashpërsimin e politikës ndëshkimore ndaj recidivistëve;
- Aplikimi me efektivitet i deklaratës së dëmit (me synim të realizimit të dëmshpërblimit nga i pandehuri në procedurë penale);
- Rishikimi i detyrave, përgjegjësive dhe bashkërendimi i procedurave të secilit institucion përgjegjës (polici, gjyqësor, mbrojtës të viktimave, prokurori) në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje;
- Hapja e një strehimoreje për djemtë dhe burrat viktime të dhunës në familje;
- Trajnimi i personelit të strehimoreve ekzistuese me qëllim që të jenë të gatshme të ofrojnë shërbime cilësore, sipas kategorive të ndryshme të viktimave të dhunës në familje, edhe për LGBT-në, komunitetin RAE dhe komunitete tjera jo-shumicë, etj.;
- Futja e programeve të veçanta për viktimat e dhunës në familje, si nënkategori e vijës kryesore buxhetore të secilës ministri/institucion;

³⁵ Rrjeti i Grave të Kosovës “Nga ligjet në vepra” (2021). Shiko: <https://womensnetwork.org/sq/publications/nga-ligjet-ne-vepra/>.

- Shfrytëzimi për strehimore i objekteve që janë në pronësi të komunave ose nga Qeveria, në përputhje me nenin 284(4) të Kodit të Procedurës Penale për asetet e konfiskuara përfshirë objektet që mund të jipen për shfrytëzim, si për banim social ashtu edhe për strehimore;
- Ofrimi i lehtësirave (pako Fiskale) për bizneset që punësojnë kategoritë e ndjeshme të shoqërisë përfshirë edhe viktimat e dhunës në familje;
- Hapja e programeve rehabilituese dhe krijimi i infrastrukturës adekuate për të punuar me kryerësit e dhunës në familje, të obligueshme për t'u ndjekur nga ana e tyre në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Angazhimi i Shërbimit Sprovues të Kosovës për ndjekjen e rehabilitimit dhe riintegrimin të kryerësve.

Grupi Punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022 - 2026, ka analizuar më tej dhe ka marrë në konsideratë edhe vështirësitë dhe sfidat e evidentuara nga këto raporte monitorimi, duke i përkthyer ato në masa dhe veprime për zbatim, si pjesë e planit të veprimit të strategjisë së re.

Vetëm ekzistenca e kuadrit ligjor kombëtar, strategjive, politikave e planeve të veprimit, apo konventave ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë nuk mjaftojnë për përmirësimin e situatës dhe reduktimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Aplikimi i masave të mbrojtjes të shprehura në ligj duhet të shoqërohet me koordinimin efektiv ndërinstitucional që mundëson planifikimin e burimeve adekuate, ofrimin e shërbimeve cilësore, vendosjen e kriterëve dhe standardeve të domosdoshme si dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Të gjitha këto duhet të shkojnë paralel me ofrimin e shërbimeve cilësore dhe adekuate, të përputhura me nevojat e grupeve të caktuara të viktimave/ të mbijetuarave të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, shërbime këto që duhet të ofrojnë mbrojtje, riintegrim dhe fuqizim të qëndrueshëm.

Është i domosdoshëm ndëshkimi i kryerësve të dhunës duke marrë në konsideratë rrethanat rënduese të veprave që i kryejnë. Njëkohësisht, trajtimi psiko-social i tyre gjatë kryerjes së ndëshkimit dhe përfshirja në programe adekuate rehabilitimi, është gjithashtu domosdoshmëri. Të ndërthurura të gjitha me edukimin dhe vetëdijesimin e mbarë shoqërisë, për të njohur, për t'u mbrojtur dhe për të ditur se si mund ta denoncojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, apo çfarë mbështetjeje u jepet, këto hapa çojnë drejt përmirësimit të situatës dhe zvogëlimin të qëndrimeve e sjelljeve që e justifikojnë dhunën.

Është e domosdoshme të theksojmë që gjatë zbatimit të masave dhe veprimeve të parashikuara, fokusi duhet të jetë tek të gjitha grupet në shoqëri, duke përfshirë gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë, duke iu dhënë përparësi grave, të rejave dhe vajzave nga zonat rurale, me aftësi të kufizuara e nevoja të veçanta, nga minoritetet etnike, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza-nëna, emigrante dhe azilkërkuese, etj.

Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 dhe planit të saj të veprimit bazohet në një tërësi dokumentesh Kushtetues³⁶, ligjorë dhe politika të veprimit, të rëndësishme si:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës miratuar nga Kuvendi i Kosovës 15.06.2008
- Kodi Penal i Kosovës, 06/L-074, datë 14.01.2019.
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur nr. 03-L193, datë 20.08. 2010.
- Kodi i Procedurës Penale, nr. 04/L-123, datë 28.12.2012, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 06/L-091 datë 04.07.2019 dhe ligjin nr.08/L-002, datë 18.06.2021.
- Ligji për Inspektoriatin Policor të Kosovës, 2008/03-L-036), datë 16.11.2010.
- Ligji për Policinë e Kosovës, nr. 04/L-076, 19.03.2012.
- Ligji për Prokurorin e shtetit, nr. 03/L-225, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 05/L-034, datë 30.06.2015 dhe ligjin nr. 06/L-025, datë 19.04.2018.
- Ligji i Punës nr. 03/L-212, datë 01.12.2010.
- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr. 05/L-021, datë 26.06.2015.
- Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, nr. 05/L-049, datë 14.04.2016.
- Ligji për afësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, nr. 03-L-019, datë 25.01.2009.
- Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, datë 16.09.2011.
- Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, datë 20.06.2015.
- Ligji për Familjen nr. 2004/32, datë 01.09.2006, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 06/L-077, datë 17.01.2019.
- Ligji për Shërbimin Mjekësor Emergjent, nr. 05/L-024, datë 21.11.2016.
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr 06/L-082, datë 25.02.2019.
- Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 03-L-182, datë 10.08.2010, (në proces ndryshimi).
- Ligji për kompensimin e viktimave të krimit, nr. 05/L-036, datë 30.06.2015.
- Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, datë 04.06.2008.
- Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, datë 04.09.2013.
- Ligji nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, datë 01.09.2011.
- Ligji nr. 2004/26 për trashëgiminë i Kosovës, i plotësuar me ligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë, datë 18.12.2018.
- Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, datë 17.07.2019.
- Ligji për Ndërmjetësim, 03/L-057, datë 20.08.2018.
- Ligji për përdorimin e substancave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorë, nr. 02/L-128, 15.08.2008.

³⁶ Renditja e ligjeve në listën më sipër është rastësore dhe jo nisur nga rëndësia e secilit Kod apo ligj në trajtimin e çështjes së dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

- Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike, nr. 03/L-142, datë 29.10.2009.
- Ligji për Shëndetësi, nr. 04/L-125, datë 07.05.2013.
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, nr. 02/L-17, datë 01.05.2007, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 02/L-17, datë 05.04.2012.
- Ligji Nr. 03/L-110, datë 6 nëntor 2008 për Ndërprerjen e Shtatzënisë, shpallur me Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 03-V-081, datë 22 janar 2009
- Ligji Nr. 02/L-76, datë 01.05.2008 për Shëndetin Riprodhues (në proces rishikimi)
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)³⁷
- Programi i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (2017-2021)³⁸
- Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018-2022³⁹
- Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Egjiptian në Shoqërinë Kosovare 2017-2021⁴⁰
- Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021⁴¹
- Programi i Kosovës për Barazinë Gjinore 2020 – 2024, miratuar me vendimin nr 01/34 datë 23.05.2020⁴²
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje, QRK-12/2012, datë 06.11.2012.
- Udhëzimi Administrativ për mënyren e trajtimit të kryerësve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope, MSH-02/2013, datë 15.02.2013.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2021 datë 22.01.2021 për Zbatimin e Drejtësisë Mike ndaj Fëmijës në Procedurën Penale, Civile dhe Administrative.
- Udhëzimi Administrativ për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare në nivel profesional, MPMS-03/2020-UA, datë 31.12.2020.
- Udhëzimi Administrativ për licencimin e organizatave jo qeveritare dhe subjekteve juridike private që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, MPMS-02/2020-UA, datë 31.12.2020, etj.

Mekanizmat Institucionalë

1. Grupi Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje. Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës krijoi (me vendimin Nr. 04/83 datë 11 korrik 2012) një Grup Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje. Grupi kryesohet nga Koordinatorja Nacionale kundër Dhunës në Familje në Ministrinë e Drejtësisë dhe nën-kryesues është Agjencia për

³⁷ Shiko: https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf.

³⁸ Shiko: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/procesi-i-integrimit-ne-bashkimin-evropian/>.

³⁹ Shiko: <https://mpms.rks-gov.net/wpdm-package/strategjia-sektoriale-2018-2022/>.

⁴⁰ Shiko: <https://www.rcc.int/romaintegration2020/files/admin/docs/a8e1293c695519e788ae28d84fb11a4.pdf>.

⁴¹ Shiko: <https://kryeministri-ks.net/documents/strategjia-sektoriale-e-shendetesise-2017-2021/>.

⁴² Shiko: <https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/ABGJ%20Programi%20i%20Kosov%20C3%ABs%20p%20C3%ABr%20Barazi%20Gjinore%202020-2024.pdf>.

Barazi Gjinore. Anëtarët zyrtarë të Grupit përfshijnë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Koalicioni i Strehimoreve shërbejnë si vëzhgues dhe ekspertë.

2. Koordinatorja Kombëtare kundër Dhunës në Familje. Bazuar në një vendimin nr. 04/83 datë 11 korrik 2012, Zëvendësministrja e Drejtësisë mban pozitën e Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje (Zyra e Koordinatorës Nacionale), ndërsa Agjencia për Barazi Gjinore mban pozitën e Nën-Kryesuesit. Zyra e Koordinatorës Nacionale duhet të mbikëqyrë zbatimin e Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në nivelin kombëtar; të koordinojë masat dhe politikat në lidhje me dhunën në familje; të mbikëqyrë bazën e të dhënave për rastet e dhunës në familje; dhe të koordinojë punën e Grupit Koordinues Ndërmintor për Dhunën në Familje. Zyra e Koordinatorës Nacionale gjithashtu harton raporte monitorimi dhe vlerësimi për Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

3. Agjencia për Barazi Gjinore. E themeluar në vitin 2005 sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ndodhet në Zyrën e Kryeministrit. Ajo ka për detyrë rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ajo gjithashtu monitoron zbatimin e ligjeve, akteve dhe dispozitave të ndryshme nga institucionet përkatëse. ABGJ mbështet rrjetin e Zyrtareve/Zyrtarëve për Barazi Gjinore në komuna e ministri dhe ato/ata duhet t'i raportojnë ABGJ-së për përpjekjet e tyre për të adresuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. ABGJ është një institucion kyç i angazhuar në grupe të ndryshme pune që hartojnë ligje, politika dhe programe për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore. Siç u përmend, ABGJ shërben si nën-kryesuese e Grupit Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje. ABGJ ka udhëhequr shumë fushata të ndërgjegjësimit rreth dhunës me bazë gjinore, përfshirë ato të ndërlidhura me ngacmimet seksuale dhe dhunën në familje. ABGJ konsultohet dhe bashkëpunon shumë ngushtë me organizatat për të drejtat e grave, duke përfshirë strehimoret, për të gjitha reformat ligjore dhe të politikave, si dhe përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore.

4. Përgjigja komunale ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (Mekanizmat Koordinues). Pas decentralizimit, komunat luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e përgjigjes ndërinstitucionale ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Komunitat menaxhojnë shëndetin, arsimin, trajnimin, punësimin dhe shërbimet sociale. Këto financohen kryesisht përmes transferimeve të buxhetit nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës. Komunitat kanë përgjegjësinë specifike për të krijuar partneritete rajonale, ndër-komunale për identifikimin, referimin, strehimin, rehabilitimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Për këtë qëllim, në nivel komunal ngrihen Mekanizmat Koordinues të cilët duhet të bashkëpunojnë për të adresuar dhunën në familje si dhe dhunën ndaj grave dhe për të menaxhuar raste specifike, sipas kornizës ligjore. Anëtarët e Mekanizmave Koordinues përfshijnë Zyrtarët për Barazi Gjinore, Policinë e Kosovës, Gjyqtarë, Qendrat për Punë Sociale, Mbrojtësit e Viktimave, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Zyrat e Punësimit, Organizata të Shoqërisë Civile duke përfshirë strehimoret dhe, në disa

komuna, gratë anëtare të Kuvendit Komunal. Ende nuk është realizuar ngritja e Mekanizmave Koordinues në të gjitha komunat e Kosovës.

5. Policia e Kosovës. Policia e Kosovës, në të shumtën e rasteve është kontakti i parë për viktimën e dhunës në familje ose të formave të tjera të dhunës ndaj grave. Zakonisht policia thirret kur një rast i dhunës në familje ose dhunës ndaj gruas ka ndodhur rishtazi, ose është i pashmangshëm. Prandaj, detyrë parësore e policisë është të hetojë rastin dhe të mbrojë viktimën. Zyrtaret dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës si reaguesit e parë të zakonshëm kanë një detyrim për t'u dhënë informacion viktimave, t'i udhëzojnë ato gjatë procesit dhe të njoftojnë akterët e tjerë. Ndërhyrja e menjëhershme e policisë përfshin kryerjen e një vlerësimi të duhur të rrezikut të situatës, vlerësimin e potencialit për dhunë të vazhdueshme dhe për shërbimet e nevojshme, si dhe për sigurimin e provave. Kur policia ndërhyr në vendngjarje, në përputhje me procedurat e ndërhyrjes për sigurinë e jetës së personave (viktimës, fëmijëve dhe familjarëve të tjerë të cilët mund të kenë qenë prezent apo të cilët banojnë në të njëjtën banesë ku po ndodh incidenti i dhunës), si dhe në zbatim të legjislacionit përkatës, duhet gjithashtu të kqyrë dhe nëse ka, të konfiskojë çdo lloj arme që gjen, pavarësisht nëse është e poseduar me leje apo jo, nga kryerësi i dhunës. Pas vlerësimit të rrezikut, policia ka një detyrim për të mbrojtur viktimat dhe për t'i informuar ato për të drejtat e tyre, të cilat mund të përfshijnë informimin mbi urdhrat e mbrojtjes, dhënien e Urdhrit për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente dhe lidhjen me akterë të tjerë për të siguruar mbështetje psikologjike, ndihmë juridike, strehim dhe ndihmë tjetër sipas nevojës. Policia duhet të ketë një plan adekuat të mbrojtjes për viktimën pasi viktima të vihet në siguri. Policia gjithashtu duhet të shoqërojë viktimat në shtëpitë e tyre për të mbledhur gjërat e tyre nëse kërkohet. Çdo njësi policore duhet të sigurojë që ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të luftuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.

Nga vlerësimet e kryera nga organizata të shoqërisë civile lidhur me zbatimin e detyrimeve të institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përsa i takon Policisë së Kosovës, evidentohet se: zyrtaret dhe zyrtarët e Policisë së Kosovës të cilët trajtojnë dhunën në familje janë më të vetëdijshëm për detyrat e tyre dhe mënyrën e trajtimit të rasteve të tilla, krahasuar me njohuritë dhe nivelin e vetëdijesimit të tyre në vitin 2017. Këtu ka ndikuar edhe përfshirja e dhunës në familje si vepër penale. Zyrtarët në mënyrë të përsëritur identifikuan dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike si forma të dhunës me bazë gjinore. Zyrtarët gjithashtu njohën veprat e reja penale në KPK si ngacmimi seksual, gjymtimi i organeve gjinitale të grave dhe ndjekja. Sidoqoftë, zyrtarët prireshin të ngatërronin dhunën me bazë gjinore me dhunën në familje dhe të kishin më pak njohuri në lidhje me sulmin seksual dhe ngacmimin seksual. Është shqetësuese që disa zyrtarë ende kishin qëndrime që i ngjanin fajësimit të viktimës. Në përgjithësi, zyrtarët e policisë të intervistuar e dinin se ata duhet të ndiqnin rastet sipas detyrës zyrtare kur ata dyshojnë se është kryer një vepër penale që përfshin dhunë me bazë gjinore, edhe nëse viktima e tërheq dëshminë. Sidoqoftë, në praktikë, ndodhin përjashtime. Zyrtarët ende duken të prirë të largojnë viktimat e jo kryesit nga vendbanimet e përbashkëta. Gjithashtu, policia nuk kryen gjithmonë vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut për të siguruar mbrojtjen e duhur të viktimave⁴³.

⁴³ Rrjeti i Grave Kosovë "Nga ligjet në vepra", Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

6. Inspektorati Policor i Kosovës. Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së tij, të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara. Inspektorati Policor/ Departamenti i Hetimeve ka detyrim hetimin e rasteve të punonjësve të policisë të cilët nuk i kryejnë siç duhet detyrat e tyre për të ndihmuar viktimat e krimit, përfshirë dhe viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Roli i kësaj njësie në ndihmën për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave vjen në shprehje kur një akt i dhunës është kryer nga një punonjës i policisë së Kosovës, ose kur një punonjës i Policisë së Kosovës nuk kryen detyrat e tij në mbrojtje dhe mbështetje të një viktime të dhunës në familje apo dhunës ndaj grave, siç parashikohen në legjislacionin në fuqi. Për këtë arsye, kjo njësi nuk do të ketë kontakt aq të shpeshtë me viktimat sa do të kenë akterët e tjerë. Megjithatë kjo njësi ka një përgjegjësi të madhe për t'i mbrojtur viktimat nga kryerësit e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe nga shkeljet ndaj ligjit nga vetë punonjësit e policisë. Anëtarët e inspektoratit të policisë duhet të marrin rolin e policit dhe t'u ofrojnë informata viktimave, t'i udhëzojnë ato gjatë procesit dhe poashtu t'i njoftojnë akterët e tjerë.

7. Mbrojtësi i Viktimave/Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV). Mbrojtësit e Viktimave janë përfaqësues të autorizuar ligjorë të viktimave të krimit dhe përfaqësojnë viktimën në prokurori dhe gjykata. Ata udhëzojnë dhe këshillojnë në iniciimin e procedurave për caktimin e masave mbrojtëse dhe i përfaqësojnë viktimat gjatë trajtimit të këtyre masave para gjykatave civile. Po ashtu, Mbrojtësit e Viktimave i përfaqësojnë viktimat përgjatë tërë procedurës penale. Mbrojtësit e Viktimave i ndihmojnë viktimat në plotësimin e kërkesave për kompensimin e viktimave të krimit dhe i referojnë në programin e kompensimit. Kategoritë prioritare ndaj të cilave ofrojnë shërbime ligjore janë viktimat e dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimet keqtrajtimet e fëmijëve, dhunimet, vrasjet, si dhe viktima të tjera të krimit. Në mënyrë që viktimat të kenë qasje më të lehtë që nga çasti i viktimizimit deri në përfundim të procedurës gjyqësore, Mbrojtësit e Viktimave, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet e drejtësisë, ofrojnë shërbime profesionale pa pagesë për hartimin e akteve, kërkesave, parashtrësive që t'u ndihmojnë viktimave të përfaqësohen më mirë në organet e drejtësisë në pajtim me të drejtën pozitive në Kosovë, duke respektuar konfidencialitetin për të gjitha viktimat që kanë pësuar të gjitha format e krimit, si dhe duke iu dhënë mbështetje ligjore dhe morale. Mbrojtësit e viktimave takohen me viktimat pas njoftimit nga Prokurori i Shtetit pas reagimit të policisë për rastin e lajmëruar të dhunës në familje apo dhunës ndaj gruas. Ky kontakt që në fillim me viktimën lejon që Mbrojtësi i Viktimave të ndërtojë një raport me viktimën, që zgjat edhe gjatë kontaktit të saj me mekanizmat e tjerë institucionalë. Përgjegjësia e Mbrojtësit të Viktimave është që të sigurojë se viktima i kupton shërbimet që mund t'i ofrohen nga Shteti dhe si mund t'i pranojë ato.

Poashtu, Mbrojtësit e Viktimave bashkëpunojnë ngushtë me institucionet tjera si agjensionet e zbatimit të ligjit, QPS-të, Institutin e Mjekësisë Ligjore, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare për të siguruar ofrimin e shërbimeve profesionale për të gjitha viktimat e krimit. Mbrojtësit e Viktimave zbatojnë strategjinë dhe vendimet e ZMNV e të Kryeprokurorit të Shtetit duke raportuar për punën e kryer në afate kohore.

Në kuadër të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave funksionon edhe Operatori i Linjës Ndihmëse, fillimisht i mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSCE). Linja punon me operatorë të cilët janë të angazhuar 24 orë dhe me një numër publik

dhe pa pagesë, për t'iu mundësuar viktimave dhe publikut një mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit, për informimin e viktimave dhe personave të tjerë lidhur me të drejtat e tyre, sigurimin e informatave të nevojshme për shërbimet ekzistuese dhe numrat ekzistues. Për vitin 2019 në Linjën Ndihmëse janë pranuar gjithësej 795 thirrje, për vitin 2020 janë pranuar gjithësej 650 thirrje dhe për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2021 janë pranuar gjithësej 120 thirrje të reja.

Të gjitha shërbimet nga ZMNV-ja ofrohen në tërë territorin e Republikës së Kosovës pa dallim. ZMNV përbëhet nga 7 zyra regjionale të vendosura në Prokuroritë themelore. Për momentin janë 24 mbrojtës të viktimave të gjithë të trajnuar për përfaqësimin e viktimave të dhunës në familje, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimet keqtrajtimit e fëmijëve, dhunimet, vrasjet, si dhe viktima të tjera të krimit dhe marrin trajnime të përhershme çdo vit.

Nga një vlerësim realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: Mbrojtësit e Viktimave (MV) kishin prirje të përdornin termat “dhunë me bazë gjinore” dhe “dhunë në familje” në mënyrë të ndërsjellë. Ndërsa zakonisht këshillojnë gratë të raportojnë dhunën në polici, disa MV mund t'i këshillojnë gratë të qëndrojnë me kryerësit e krimit nëse kanë fëmijë, gjë që mund t'i vendosë gratë dhe fëmijët në rrezik. MV-të nuk janë gjithmonë të pranishëm në stacionet e policisë kur viktimat raportojnë dhunë dhe shpesh mungojnë në seancat gjyqësore, për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore. Ata gjithashtu nuk i ndihmojnë gjithmonë viktimat në paraqitjen e kërkesave për kompensim. Përndryshe, MV-të kanë prirje të zbatojnë detyrat e tyre sipas PSV-ve⁴⁴.

8. Prokurori i Shtetit. Bashkëveprimi në mes të Prokurorit dhe viktimës së dhunës në familje apo dhunës ndaj grave zakonisht vjen në shprehje në procesin e mëvonshëm të raportimit. Prokurorët kanë për obligim t'i ndërmarrin masat e nevojshme varësisht nga vlerësimi i rrezikshmërisë së rastit konkret të dhunës në familje. Ata i vlerësojnë rastet e dhunës në familje, historinë kriminale të kryerësit dhe shkeljet e urdhërave mbrojtës për të përcaktuar nëse ka prova të mjaftueshme për t'i ndjekur kryerësit e dhunës në familje. Viktima e dhunës në familje është palë në procedurë dhe njëkohësisht dëshmitarja kryesore e prezantuar në gjykatë nga ana e prokurorit. Mbi të gjitha, prokurori ka për obligim që të bëj sigurimin e provave dhe të procedojë me ndjekjen penale bazuar në ato prova pa marrë parasysh vullnetin e viktimës për të proceduar më tutje apo jo me ndjekjen penale. Prokurori poashtu ka për obligim bashkëpunimin me mbrojtësin e viktimave, i cili ndihmon prokurorin gjatë gjithë procedurës duke shërbyer si urëlidhës mes prokurorit dhe viktimës. Prokurori ka për obligim që të informojë viktimën lidhur me të drejtat e viktimës në procedurë, të drejtën në kompensim si dhe statusin e rastit të saj/tij.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: “Prokurorët kanë prirje të jenë të informuar në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore, përveç gjymtimit gjenital të femrave. Disa gjithashtu ngatërruan sulmin seksual me ngacmimin seksual. Disa shprehën pasiguri në lidhje me mënyrën se si të përdorët vepra e re penale e dhunës në familje, veçanërisht në kombinim me vepra të tjera. Disa prokurorë specialë janë emëruar. Prokurorët kishin marrë pjesë në trajnimin mbi dhunën në familje dhe ata kishin prirje të dinin përgjegjësitë e tyre. Përfaqësuesit e institucioneve të tjera konfirmuan se prokurorët e

⁴⁴ Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

kryejnë mirë rolin e tyre. Kjo sugjeron përmirësim që nga viti 2017, kur disa prokurorëve u dukej se nuk kishin njohuri dhe profesionalizëm në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Përvoja e tyre në trajtimin e dhunës seksuale mbetet e kufizuar, kryesisht për shkak të raportimit të ulët të këtyre krimeve”⁴⁵.

9. Gjykatat. Gjykatat i shqyrtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Këto raste trajtohen nga gjykata në procedurë civile apo penale varësisht nga natyra e rastit. Në raste të rralla gjykatat janë ofruesit e parë të shërbimeve që ballafaqohen me viktimën e dhunës në familje apo të dhunës ndaj grave. Gjykatat, kanë përgjegjësinë e trajtimit të palëve dhe individëve që shfaqen para tyre, në mënyrë të paanshme, dinjitoze dhe me respekt, duke siguruar mbrojtje adekuate për të gjitha palët e përfshira në procedurë. Në procedurë civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente dhe shqiptojnë masat mbrojtëse të parapara me ligj. Në procedurë penale, organet hetuese janë kompetente të vendosin për rastet e ndjekjes penale të kryerësve të dhunës në familje, të cilët kanë shkelur urdhërin për mbrojtje, ose personat që kanë kryer vepër penale në marrëdhënie familjare. Me rastin e vendosjes për lartësinë e dënimit, gjykatat kanë për obligim të marrin gjithnjë parasysh rrethanat relevante rënduese sipas Kodit Penal me qëllim të caktimit të dënimit proporcional dhe sa më efektiv për kryerësin. Gjykatat kanë për obligim që t’i njoftojnë të gjitha palët në procedurë për të drejtat që u përkasin atyre, si dhe pasojat e mosveprimit të tyre.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: “...Megjithëse gjyqtaret/gjyqtarët ishin në dijeni të ndryshimeve në Kodin Penal të Kosovës dhe përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, jo të gjithë kishin një kuptim gjithëpërfshirës të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht të formave të ndryshme të dhunës seksuale. Gjykatat kishin hasur në disa raste ndjekjeje, sulmi seksual, përdhunimi ose ngacmimi seksual. Shumica e rasteve të dhunës me bazë gjinore që kishin trajtuar kishin të bënë me dhunën në familje. Gjyqtarët ranë dakord që rastet e dhunës në familje tani janë me prioritet më shumë se më parë, por monitorimi sugjeron që vonesat vazhdojnë, duke i vendosur gratë në rrezik të madh të dhunës së mëtejshme. Fenomeni i grave që “tërheqin” dëshmitë e tyre dhe akuzave penale që u hodhën siç duket vazhdon, pavarësisht nga detyrimet e qarta ligjore për të vazhduar sipas detyrës zyrtare ndjekjen penale. Dënimi për krimet e dhunës në familje mbetet i ulët. Disa gjyqtarë ende kërkojnë të pajtojnë familjet, megjithëse kjo nuk është brenda mandatit të tyre kur gratë dhe fëmijët janë në rrezik të dhunës. Ende gjyqtarët nuk e konsiderojnë interesin më të lartë të fëmijës, duke i dhënë përparësi mirëqenies ekonomike mbi mirëqenien fizike dhe mendore. Përdorimi më i mirë i masave të urdhrit të mbrojtjes dhe pagesave të alimentacionit në lidhje me vendimet përfundimtare të kujdestarisë së fëmijëve mund të ndihmojë në adresimin e kësaj. Veçanërisht, frika nga humbja e kujdestarisë së fëmijëve është një arsye kryesore pse gratë durojnë dhunën dhe nuk e raportojnë atë, kështu që gjykatat kanë përgjegjësinë për të ndihmuar në adresimin e kësaj çështjeje. Ende caktohen disa masa në urdhrat e mbrojtjes, gjë që pengon një qasje gjithëpërfshirëse, të fokusuar te viktima. Nevojiten hulumtime të mëtejshme në lidhje me shkaqet e viktimave që tërheqin kërkesat për urdhër mbrojtjeje ose kërkojnë dënime të buta, si dhe mbi kujdestarinë e fëmijëve në lidhje me urdhrat e mbrojtjes...”⁴⁶.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Po aty.

10. Instituti i Mjekësisë Ligjore/Ministria e Drejtësisë. Viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave takohen me personelin e Institutit të Mjekësisë Ligjore në bazë të urdhëresës nga organet e hetuesisë dhe gjyqësisë. Qëllimi i ekzaminimit është të sigurojë prova dhe të vërtetojë nëse ndaj personit është ushtruar ndonjë formë e dhunës. Instituti i Mjekësisë ligjore mund të bëjë ekzaminimin e një viktime vetëm me pëlqimin e viktimës. Idealisht ekzaminimi duhet të bëhet në kohën që do të mundësonte një përshkrim të saktë të lëndimeve të viktimës. Këto ekzaminime duhet të bëhen me kujdes dhe respekt ndaj gjendjes së viktimës.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: “... Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) ka përmirësuar njohuritë dhe kapacitetet e veta në mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore që nga viti 2017. Për më tepër, IML ka bërë përpjekje për të informuar njerëzit, veçanërisht të miturit, për rëndësinë e raportimit të krimeve në kohën e duhur, të tilla si përdhunimi dhe sulmet seksuale. Sidoqoftë, stigmatizimi dhe presioni shoqëror, përfshirë anëtarët e familjes, mund të parandalojnë gratë dhe vajzat të paraqiten ose të kërkojnë drejtësi. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet Policisë së Kosovës, IML dhe prokurorisë me sa duket pengon referimin në kohë të rasteve të dhunës seksuale në mënyrë që të ruhen provat biologjike. Kosova ende nuk ka një qendër referimi të dhunës seksuale ose një qendër krize të përdhunimit të specializuar në një trajtim të tillë siç parashikohet nga Konventa e Stambollit...”⁴⁷

11. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka mandat hartimin e politikave, programeve, infrastrukturës ligjore si dhe bën monitorimin e kualitetit të shërbimeve sociale. Departamenti i Mirëqenies Sociale në mënyrë specifike, është përgjegjës për shpërndarjen e fondeve për strehimoret në kohën e duhur, si dhe licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale, monitorimin e cilësisë së shërbimeve të tyre dhe performancën e oficerëve të shërbimit social përgjegjës për menaxhimin e rasteve.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: “... Ka pasur përmirësime të ndjeshme në financimin e shtetit për strehimoret që nga viti 2017. Sidoqoftë, financimi i mjaftueshëm, i qëndrueshëm, i mirë planifikuar dhe i mbrojtur ligjërisht mbetet çështje për strehimoret, veçanërisht drejt aftësisë së tyre për të siguruar plane rehabilitimi gjithëpërfshirëse, të përqendruara në viktima dhe riintegrim dhe shërbimet shoqëruese. Kosova ende nuk ka hapësirë të mjaftueshme strehimi sipas Konventës së Stambollit; nuk ka një strehimore për djemtë mbi moshën 12 vjeç që të jenë me nënat e tyre; nuk ka shërbime për personat LGBTI+; dhe nuk ka shërbime të tjera të specializuara për viktimat e dhunës përveç dhunës në familje dhe trafikimit, siç parashikohet nga Konventa e Stambollit...”⁴⁸

12. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. MAPL ka si mision, ndër tjera, të kontribuojë në: rritjen e aftësisë së komunave për të rritur cilësinë e jetës dhe sigurinë, respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga organet e vetëqeverisjes lokale, etj. Në kuadër të MAPL, ekziston Divizioni për Avancimin e të drejtave të Njeriut si dhe në nivel lokal janë mekanizmat për të drejtat e njeriut - Njësia për të Drejtat e Njeriut në komunë. Duke pasur parasysh që Strategjia Kombëtare është dokument i nivelit qendror, MAPL mund të japë

⁴⁷ Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>.

⁴⁸ Po aty.

kontributin e saj si urë lidhëse ndërmjet nivelit qendror dhe lokal, për zbatimin sa më të mirë të kësaj Strategjie dhe mund të ndjekë më afër këtë zbatim në komunat e Kosovës.

13. Komunat/ Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Drejtoratet për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si bartëse të pushtetit lokal janë të mandatuara që të bëjnë menaxhimin e shërbimeve sociale në komunë. Në nivel komunal, Këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, rezultoi i ngritur në 20 komuna për vitin 2021, pra njëlloj si në vitin 2020, ndërkohë që për vitin 2019 ky këshill rezultonte në vetëm 12 komuna. Për më tepër, Komunat në kuadër të drejtorateve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale zhvillojnë programe mbështetëse për viktimat në kuadër të shërbimeve sociale duke përfshirë mbështetjen financiare për strehimoret për viktimat e dhunës. Komunat si të vetme ose në bashkëpunim me komuna tjera të regjioneve të njëjta mund të kontribuojnë në qëndrueshmërinë financiare të strehimeve duke participuar në mbulimin e shpenzimeve të komunalive, sigurimin e ngrohjes për strehimoret, sigurimin e objektit adekuat, koordinimin për programe të ndryshme të ri-integrimit etj. Komunat kanë përgjegjësi që përmes përdorimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të sigurojnë buxhet për strehimin social, kujdesin ndaj fëmijëve (çerdhe e kopshte, etj.)

14. Qendrat për Punë Sociale. Qendra për Punë Sociale është institucion publik i nivelit komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale dhe familjare, në këtë kontekst edhe mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje, të rritur e fëmijë, apo viktimave të dhunës ndaj grave e vajzave, deri në riintegrim e fuqizim të qëndrueshëm të viktimës, në koordinim me akterët e tjerë. Qendra për punë sociale (QPS) ndihmon viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave kur nevojiten shërbimet sociale, mbrojtje, riintegrim dhe fuqizim i qëndrueshëm i tyre në shoqëri. Çdo viktimitë të referuar i caktohet një menaxhere/menaxher i rastit, e cila/i cili është zyrtarë/zyrtar që emërohet nga QPS për të ndihmuar në identifikimin dhe koordinimin e shërbimeve ekzistuese, duke ndihmuar personin në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës të menaxhimit të rastit. Kjo duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të QPS, për të siguruar ndihmë gjithëpërfshirëse për sigurinë, strehimin, drejtësinë, arsimin, trajnimin, punësimin, ndihmën sociale dhe ndihmën juridike. Menaxherja/menaxheri i rastit duhet të koordinojë dhe mbështesë zbatimin e këtij plani, duke përfshirë monitorimin e tij. Menaxherja/menaxheri i rastit merr pjesë në të gjitha seancat e ftuara nga Gjykata dhe paraqet anamnezën e rastit, apo raporte të tjera sipas kërkesës dhe në përputhje me funksionin e saj/tij.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: "...Të anketuarit e QPS-ve nuk kishin informacion në lidhje me dhunën e bazuar në gjini, përfshirë këtu edhe atë të bazuar në Kodin Penal të ndryshuar. Disa ende rekomandojnë që prindi me një situatë më të mirë financiare të marrë kujdestarinë e fëmijës, në vend që të përqendrohen në mirëqenien e përgjithshme të fëmijës. Në mënyrë interesante, punonjësit e QPS-ve ende kishin tendencë të përpiqeshin për të pajtuar çiftet, duke e vendosur viktimën në rrezik, në kundërshtim me Konventën e Stambollit, LMDHF dhe PSV-të. Të gjitha këto çështje tregojnë kufizime në kapacitetet e tyre profesionale. Për më tepër, punonjësit socialë shpesh mungojnë në seancat gjyqësore dhe nuk i përcjellin familjet që kanë përjetuar dhunë. Për shkak të kufizimeve buxhetore, veçanërisht në mes të decentralizimit QPS-të vazhdojnë të përballen me disa sfida të burimeve në lidhje me burimet njerëzore dhe infrastrukturën. Këto kufizime e bëjnë të vështirë për ta që të paraqiten në stacionet e policisë dhe seancat gjyqësore. Në të njëjtën kohë, këto mangësi demonstrojnë përgjegjësi të pamjaftueshme në emër të QPS-ve në sigurimin e

burimeve të përshtatshme profesionale dhe njerëzore për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe fëmijëve. Kështu, performanca e tyre ishte përmirësuar pak ose aspak që nga viti 2017...”⁴⁹

15. Agjencia për ndihmë juridike falas/ Zyrat Rajonale për Ndihmë Juridike. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas/Zyrat Rajonale për Ndihmë Juridike ofron ndihmë juridike falas për viktimat të cilat gëzojnë të drejtën për këtë lloj ndihme. Ata mundësojnë qasjen e viktimave në drejtësi, duke u dhënë informata dhe këshilla viktimave për të drejtat ligjore, përfaqësojnë viktimat para gjykatave ose organeve administrative dhe ndihmojnë në hartimin e procedurave dhe dokumenteve ligjore. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas bashkëpunon edhe me mbrojtësit e viktimave për t’u siguruar që viktimat e dhunës në familje çdo herë të kenë qasje në shërbime pa pagesë sidomos në procedurat civile p.sh. në përpilimin e padive për shkurorëzim apo kujdestari të fëmijëve etj.

16. Drejtoratet Komunale për Arsim/Institucionet arsimore. Drejtoratet Komunale të Arsimit janë përgjegjës për informimin dhe edukimin e viktimave të dhunës në familje apo të dhunës ndaj grave sipas ligjit në fuqi. Institucionet arsimore janë burime të rëndësishme veçanërisht për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve vajza dhe djem viktimat të dhunës në familje. Derisa punonjëse/punonjës të institucioneve arsimore kanë kontakte të shpeshta dhe të përsëritura me fëmijët, ato/ata janë në një pozitë ku mund ta identifikojnë dhunën në familje, e cila përndryshe mund të mbetet e pa raportuar. Institucionet arsimore mund të sigurojnë mbështetje fëmijëve viktimat në një mjedis të përshtatshëm që nuk e pengon jetën e tyre në shtëpi dhe familjet e tyre. Këto institucione kanë një rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijesimit mbi ngritjen e ndërgjegjësimit lidhur me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave dhe njoftimin e akterëve të tjerë kur një fëmijë ka nevojë për mbrojtje. Ata gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur në parandalimin e dhunës. Edukimi i vazhdueshëm që në moshë të re, që kërkon të transformojë rolet tradicionale gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit, mund të kontribuojë në parandalimin e dhunës. Siç theksohet në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, departamentet komunale janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e disponueshmërisë adekuate të shërbimeve parashkollore dhe të kujdesit ndaj fëmijëve, shërbime këto të përbalueshme e të aksesueshme në nivel komunal, të cilat mund të jenë vendimtare për autonominë e prindërve të vetëm, si pjesë e programeve gjithëpërfshirëse të riintegritit.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: “... Kurrikulat arsimore përfshijnë informacion mbi dhunën në familje, por ndoshta më pak për format e tjera të dhunës me bazë gjinore dhe për transformimin e roleve tradicionale gjinore. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim e ka bërë më të lehtë raportimin e rasteve të mundshme të dhunës në familje, por personeli arsimor nuk është në dijeni të tij dhe kështu nuk e përdorin atë. Edukatorët kishin njohuri minimale në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe si të ndërveprojnë me personat që kanë pësuar dhunë. Kjo, e shoqëruar me normat kulturore, mund të nënkuptojë që edukatorët jo gjithmonë raportojnë dhunën kur ajo ndodh, përkundër detyrimit të tyre ligjor për ta bërë këtë. Kjo sugjeron një nevojë për trajnime të mëtejshme të detyrueshme. Shkollat nuk kanë mjaft arsimtarë ose psikologë për të ndihmuar

⁴⁹ Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>.

në mënyrë adekuate fëmijët që kanë nevojë për ndihmë shtesë. Programet e posaçme arsimore të financuara nga qeveria ekzistojnë për viktimat...”.⁵⁰

17. Institucionet Shëndetësore: parësor, dytësor, tretësor dhe qendrat e shëndetit mendor. Institucionet shëndetësore kanë rol të rëndësishëm si në identifikimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, ashtu edhe në trajtimin dhe referimin e tyre tek akterët e tjerë përgjegjës. Institucionet shëndetësore sipas Kodit Penal e kanë detyrim së bashku me institucionet e arsimit raportimin e rasteve në polici. Zakonisht, institucionet shëndetësore janë akterët e parë që kanë kontakt me një viktimë të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave. Për këtë qëllim nevojitet standardizimi i shërbimeve përmes përgatitjes së protokolleve të trajtimit të rasteve, që në momentin e parë që u qasen institucioneve shëndetësore. Këto protokolle duhet të përgatiten bazuar edhe në modelet dhe standardet ndërkombëtare për këtë qëllim. Po kështu, të mbështetur në protokollin klinik të trajtimit të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave të cilat paraqiten në institucionet shëndetësore, psikologët dhe psikologët pjesë e organikës së këtyre institucioneve duhet të mundësojnë trajtimin psikologjik të viktimave përmes terapive që mund të planifikohen si cikël me 12-15 seanca, varësisht nevojës, llojit të dhunës së ushtruar, e përshkallëzimit të saj. Për më tepër, ata kanë përgjegjësinë të mbështesin kujdesin afatmesëm dhe afatgjatë për personat që kanë pësuar dhunë, duke përfshirë shërbimet fizike dhe psikologjike, e duke përdorur një qasje të përqendruar te viktima.

Nga vlerësimi realizuar nga organizatat e shoqërisë civile (2021), evidentohet se: “...Ashtu si në vitin 2017, punonjësit e kujdesit shëndetësor ende nuk kishin njohuri rreth formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore përveç dhunës në familje, LMDHF, PSV-të dhe mënyrën më të mirë për të trajtuar personat që vuanin dhunë me bazë gjinore, kryesisht sepse nuk kishin ndjekur trajnim. Punonjësit shëndetësor kanë një protokoll të veçantë për trajtimin e formave të dhunës me bazë gjinore përveç gjymtimit të organeve gjenitale. Ata e dinë detyrën e tyre për t’i referuar viktimat në polici dhe thanë se e bëjnë rregullisht këtë. Kujdesi shëndetësor fizik dhe mendor është në dispozicion për viktimat. Ndërkohë, shërbime gjithëpërfshirëse të rehabilitimit si për viktimat ashtu edhe për kryerësit e krimeve mund të përmirësohen duke avancuar kapacitetet profesionale të punonjësve të kujdesit shëndetësor, përfshirë trajtimin e normave gjinore, menaxhimin e zemërimit dhe marrëdhëniet tradicionale të pushtetit...”.⁵¹ Gjetje të tilla tërheqin vëmendjen për ndërhyrje të menjëhershme institucionale për fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve e profesionistëve të shëndetësisë, si dhe për përmirësimin e ndërhyrjeve përmes përgatitjes dhe rishikim-plotësimit të protokolleve e mjeteve të tjera të nevojshme, në funksion të rritjes së efektivitetit të ndërhyrjes.

18. Zyrat Regjionale të Avokatit të Popullit. Zyrat Regjionale të Avokatit të Popullit kanë këtë organizim: njësinë për barazi gjinore dhe zyrtarin për barazi gjinore. Avokati i Popullit ka përgjegjësinë për të adresuar akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut nga shteti. Dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë çështje të të drejtave të njeriut. Prandaj kur një viktimë e dhunës në familje apo dhunës ndaj grave është keqtrajtuar nga një institucion i Kosovës në trajtimin e një çështje të dhunës së ushtruar ndaj saj, viktimat mund të raportojnë rastin te Avokati i Popullit për hetime dhe ndihmë. Avokati i Popullit mund t’u bëjë rekomandime

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

institucioneve dhe organeve të tjera qeveritare se si të përmirësojnë performancën e tyre dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Nga vlerësimi i realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: "... Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka themeluar një Departament për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili merret me çështjet e barazisë gjinore. IAP ka shtatë zyra rajonale, dhe çdo zyrë ka një Njësi të Barazisë Gjinore dhe një Zyrtar për Barazi Gjinore. Raportet vjetore të IAP-së për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk përmendin sa ankesa kanë marrë në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Në vitin 2019, IAP pranoi 65 raste në lidhje me barazinë gjinore, dhe 39 raste janë hapur për hetim, por raporti i tyre nuk specifikon nëse këto kishin të bënin me dhunën me bazë gjinore. IAP ende nuk ka një sistem adekuat të menaxhimit të të dhënave për të gjurmuar në mënyrë sasiore llojet e rasteve të ndihmuara dhe rezultatet e tyre, por është në planifikim që të zhvillohet një bazë të tillë të të dhënave..."⁵²

19. Ministria e Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë ka mandatin të zhvillojë politika, udhëzime dhe protokolle, programe, infrastrukturë ligjore dhe të monitorojë cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe psiko-sociale për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, dhunës ndaj grave, si dhe dhunës seksuale në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

20. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. MASHTI ka mandat të zhvillojë politika, programe, plan-programe, infrastrukturë ligjore dhe të monitorojë cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet.

21. Oda e Avokatëve të Kosovës. Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) është organizatë vetëqeverisëse e avokatëve të Kosovës, e themeluar me ligj, e cila vepron si e pavarur nga organet shtetërore. Avokatia u ofron shërbime dhe ndihmë profesionale juridike personave fizikë dhe juridikë në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në pajtim me rendin juridik. OAK është e përfshirë në programe të ndihmës juridike falas, andaj shumë shpesh i përfaqësojnë viktimat e krimit në procedurat penale kryesisht në rastet kur caktohen me detyrë zyrtare nga gjykatat. Avokatet/avokatët shpesh angazhohen edhe nga vetë viktimat në plotësimin dhe parashtrimin e kërkesave për kompensim të viktimave të krimit. OAK siguron trajnime profesionale për ngritjen e nivelit të kompetencës dhe shkathtësive praktike të anëtarëve/anëtarëve të vet në raport me përfaqësimin profesional të viktimave.

22. Shërbimi korrektues: punon me autorët gjatë kohës që janë në burg si pjesë e planeve të tyre të menaxhimit të rasteve drejt transformimit të normave dhe marrëdhënieve gjinore, sfidimit të marrëdhënieve të pushtetit, trajtimit të varësive dhe menaxhimit të zemërimit. Dënimet me kusht, përveçse sa më sipër përfshijnë monitorimin e autorëve dhe mbështetjen e tyre në programet rehabilituese.

23. Qendrat e Trajnimit Profesional punojnë dhe të mbështesin viktimat për të fituar aftësi në fushat e kërkuara në fuqinë punëtore, duke përdorur një qasje të ndjeshme gjinore.

24. Zyrrat e Punësimit u japin përparësi shërbimeve për viktimat në gjetjen e punësimit si pjesë e planeve të mbështetjes dhe fuqizimit.

⁵² Po aty.

Partnerët mbështetës joqeveritarë

1. Strehimoret. Sipas Konventës së Stambollit, qeveria ka përgjegjësi të sigurojë shërbime cilësore të strehimoreve për viktimat e dhunës ndaj grave, duke përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje. Në Kosovë, qeveria kontraktonte strehimore joqeveritare për të ofruar këto shërbime. Aktualisht, shumica e strehimoreve u shërbejnë grave dhe fëmijëve që kanë vuajtur nga dhuna në familje dhe trafikimi. Strehimoret e emergjencës dhe të tjera veçanërisht për personat që kanë pësuar dhunë seksuale nuk janë ende të disponueshme dhe të rregulluara qartë. Strehimoret për viktimat djem mbi 13 vjeç, burra dhe persona LGBTI+ të dhunuar, nuk ekzistojnë. Strehimoret u ofrojnë viktimave një vend të sigurt për të jetuar pas përjetimit të rastit të dhunës në familje, trafikimit, dhunës seksuale, etj. Viktimat mund të kërkojnë ndihmë nga një strehimore drejtpërdrejtë ose mund të referohen në strehimore nga një ofrues tjetër i shërbimeve. Strehimoret janë vendbanime të përkohshme që ofrojnë jo vetëm mbrojtje për viktimën por edhe e ndihmojnë viktimën në procesin e rekuperimit nga dhuna në familje dhe riintegrimin e fuqizimit për të vazhduar jetesën në mënyrë sa më të pavarur në shoqëri. Në disa raste, godinat në të cilat Strehimoret ushtrojnë aktivitetin e tyre janë në pronësi të Komunave. Vënia në dispozicion e tyre është një mundësi që Komunitat kanë gjetur për të lehtësuar funksionimin e këtij shërbimi kaq të rëndësishëm. Në Kosovë ekzistojnë gjithsej 7 strehimore⁵³ si shërbime mbështetëse të specializuara për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave⁵⁴.

2. Organizatat jo-qeveritare. Disa OJQ, posaqërisht OJQ-të për gratë janë të familjarizuara me problemin e viktimës së dhunës në familje apo të formave të tjera të dhunës ndaj grave dhe janë të njoftuara mirë për trajtimin e tyre. Ato mund të parashirojnë një kërkesë për urdhër për mbrojtje dhe/ose urdhër për mbrojtje emergjente. OJQ gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm në: ndërgjegjësimin për format e ndryshme të dhunës ndaj grave e dhunës në familje dhe mënyrën e raportimit të saj, parandalimin, asistimin e viktimave të cilat vuajnë dhunën, kryerjen e hulumtimeve të orientuara drejt politikave, si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përgjegjëse, e llogaridhënies së tyre.

Nga vlerësimi realizuar nga organizatat e shoqërisë civile, evidentohet se: "... Përveç strehimoreve, PSV-të parashirojnë që organizatat e tjera të shoqërisë civile (OSHC) gjithashtu mund të mbështesin viktimat përmes këshillimit psikologjik ose ligjor, ndërgjegjësimin dhe/ose ndihmës në aplikimin për një UMPE. Në vitin 2017, të anketuarit nga OSHC-të treguan se viktimat e dhunës në familje ndjehen me rehatshëm të vijnë tek ata sesa të shkojnë në polici, për shkak të stigmave shoqërore që lidhen me dhunën në familje. Për më tepër, OSHC-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e qeverisë dhe mbajtjen e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore përkatëse. OSHC-të gjithashtu mbështesin qeverinë për të zbatuar më mirë kornizën ligjore përmes ekspertizës së tyre. OSHC të shumta punojnë me grupe të marginalizuara të cilat mund ta kenë të vështirë të kërkojnë ndihmë nga aktorë të tjerë për shkak të frikës se institucionet shtetërore mund t'i diskriminojnë ata, ose ata kanë pak qasje në burime të disponueshme. OSHC-të gjithashtu ofruan referime dhe ndihmuan grupe

⁵³ "Krijimi i Hartës së Shërbimeve Mbështetëse për Viktimat e Dhunës ndaj Grave në Kosovë", 2017, përgatitur në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës, "Forcimi i luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë. Shiko: <https://rm.coe.int/seminar-pristina-report-alb/16807316e0>.

⁵⁴ Për më shumë detaje mbi numrin e rasteve të trajtuara në disa nga strehimoret, lutemi referohuni tek shtojca 3 në këtë Strategji.

potencialisht të marginalizuara ose të cenueshme. Në përgjithësi, OSHC-të kanë kontribuar kështu në zbatimin e kornizës përkatëse ligjore përmes ndërjegjësimit, referimeve, ofrimit të shërbimeve, monitorimit të gjykatave, ndihmës juridike dhe institucioneve të trajnimit, megjithëse ato rrallë kanë mbështetje financiare nga qeveria për këtë punë..”⁵⁵.

Parimet kryesore

Parimet Kryesore që udhëheqin Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 dhe Planin e saj të Veprimit janë:⁵⁶

- ***Përparimi drejt një qasje transformuese gjinore:*** ekzaminimi, gjetja e shkaqeve dhe ndryshimi i normave të ngurta gjinore e pabarazive të pushtetit që dëmtojnë gratë dhe vajzat dhe gjenerojnë diskriminim në të gjitha moshat, duke filluar nga fëmijëria e hershme, në shoqëri; promovimi i ndryshimeve në qëndrimet shoqërore, përfshirë këtu angazhimin në mënyrë aktive të burrave dhe djemve, duke u përqendruar te të rinjtë si nxitës të ndryshimit; të punuarit në një mënyrë që është e ndjeshme ndaj kontekstit; të krijuarit e partneriteteve të forta dhe dialogut me aktorët vendorë, shoqërinë civile dhe komunitetet vendore, duke mbështetur edhe organizatat e grave.
- ***Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje:*** mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, është parakusht për zhvillimin e një vendi; çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.
- ***Ndjekja e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut:*** e cila vendos parimet e mos-diskriminimit, trajtimit të viktimave me dinjitet dhe respekt nga institucionet përgjegjëse dhe kundërveprimit për pabarazitë në qendër të të gjitha veprimeve. Kjo përfshin ndihmën për çdo qenie njerëzore për të ushtruar të drejtat e tyre njerëzore, për të marrë pjesë në vendimet që kanë të bëjnë me to dhe për të kërkuar dëmshpërblim kur u shkelen të drejtat.
- ***Adresimi i ndërthurjes së diskriminimit gjinor me forma të tjera të diskriminimit:*** fokusi duhet të jetë gjithashtu tek gratë më të pafavorizuara, për shembull gratë rome, dhe egjiptiane, gra me aftësi të kufizuara, gra të privuara ekonomikisht dhe shoqërisht, gra që jetojnë në fshat, gra të dhunuara, nëna të vetme, gra emigrante dhe azilkërkuese, gra LGBTI+, gra të moshuara, etj., pasi ato përballen me diskriminim të shumëfishtë.
- ***Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit:*** ndërmjet vajzave, të rejave dhe grave, si dhe djemve, të rinjve dhe burrave, për sa i përket moshës, aftësisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike dhe shoqërore, praktikave fetare dhe zgjedhjeve jetësore.
- ***Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional:*** nisur nga karakteristikat dhe natyra ndërsektoriale e çështjeve që përbëjnë qëllimet kryesore të kësaj strategjie, institucionet shtetërore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, media, sektori privat, institucionet fetare, organizatat ndërkombëtare si dhe të gjithë akterët dhe partnerët e interesuar, duhet të punojnë së bashku duke koordinuar veprimet për të adresuar sa më

⁵⁵ Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>.

⁵⁶ Tre parimet e para janë parimet tek të cilat bazohet edhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së (fq.4). https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf.

efektivisht pabarazitë dhe padrejtësitë me bazë gjinore për gratë/të rejtat/vajzat dhe burrat/të rinjtë/djemtë.

- **Matja e përparimit, buxheti dhe alokimi i fondeve adekuate për zbatimin e strategjisë dhe planit të saj të veprimit:** si në çdo dokument politik të hartuar, në Strategjinë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 nuk mund të mungojnë treguesit që do të shërbejnë për matjen e përparimit gjatë periudhave kohore të zbatimit të saj. Po kështu, që gjatë hartimit të strategjisë është mundësuar kostimi i veprimeve, pra një parashikim buxhetor ku përlllogariten kostot e domosdoshme për zbatim, të ndara në periudha të caktuara, ku evidentohen edhe ato masa apo aktivitete të cilat nuk mund të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe që kanë nevojë për mbulim të plotë apo bashkëfinancim nga donatorët. Garantimi i buxhetimit dhe alokimit të përvitshëm të fondeve adekuate, bazuar në kostimin që përmban dokumenti, do të jetë një prej treguesve kryesorë të përparimit dhe të rritjes së përgjegjshmërisë institucionale në nivel qendror e lokal, që do të çojë padyshim drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara.
- **Qasja me në qendër viktimën:** përkufizohet si fokusi sistematik në nevojat dhe shqetësimet e një viktime për të siguruar ofrimin e shërbimeve në mënyrë të ndjeshme dhe jogjyquese ndaj viktimave. Me fjalë të tjera qasja me në qendër viktimën nënkupton vendosjen e nevojave dhe prioriteteve të viktimave të dhunës në familje apo dhunës ndaj grave, në ballë të çdo reagimi. Qasja me në qendër viktimën duhet të ndiqet nga çdo institucion që ka kontakt me viktimën. Planifikimi, hartimi dhe dhënia e përgjigjeve të koordinuara duhet të synojë të mbështesë parimet bazë në vijim, të cilat gjithashtu duhet të përfshihen në trajnimin profesional dhe praktikant e të gjitha institucioneve e agjencive që japin përgjigjen e koordinuar. Këto parime përfshijnë: a) Trajtimi i viktimave me dinjitet dhe respekt; b) Qasja e viktimave në një mjedis të sigurt, mbështetës dhe jogjyques; c) Qasja e viktimave në informacionin e duhur; d) Dhënien mundësi viktimave për të bërë një zgjedhje të informuar; e) E drejta e viktimave për privatësi dhe konfidencialitet, etj⁵⁷.
- **Parimi i kujdesit të duhur dhe llogaridhënies:** strategjia përcakton qartë se si të gjitha institucionet e përfshira në qasjen ndërsektoriale duhet të aplikojnë parimin e kujdesit të duhur, i cili mbart me vete detyrime strikte. Rrjedhimisht, specifikohet në kapitullin përkatës pjesa e monitorimit, llogaridhënies dhe vlerësimit. Po kështu, edhe në masat dhe veprimet e parashikuara, planifikohet fuqizimi i mekanizmave institucionale përgjegjës të cilët do të përmirësohen edhe në lidhje me performancën e tyre sa i takon llogaridhënies. Kjo do të zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve, përfshirë strehimoret. Parimi i kujdesit të duhur është shumë i rëndësishëm pasi shteti ka fuqi, aftësi dhe interes të jashtëzakonshëm për të formuar, toleruar, inkurajuar dhe zhvilluar vlerat dhe kulturën. Shteti duhet të marrë masa për të mbrojtur gratë dhe vajzat kundër praktikave negative sociale dhe kulturore që janë të dëmshme për mirëqenien, dinjitetin dhe shëndetin e tyre. Shteti duhet të ushtrojë parimin e kujdesit të duhur për të promovuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e njeriut – një detyrim që shtrihet në parandalimin e abuzimeve të të drejtave të njeriut nga shteti dhe aktorët e tij, si dhe nga aktorët joshtetërorë. Kjo shtrirje pranon se dhuna ndaj grave, qoftë e kryer nga aktorë shtetërorë apo joshtetërorë, përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe si e tillë e detyron shtetin të

⁵⁷ Për më shumë shiko: <https://www.endvawnow.org/en/articles/1790-victim-survivor-centred-approach.html>.

hyjë në të ashtuquajturën 'sferë private' ku ndodhin shumica e rasteve të dhunës ndaj grave.

- ***Ndërthurja/ndërsektorialiteti i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje:*** përfshin marrjen në konsideratë të ndërthurjes së gjinisë me pabarazitë/faktorët e tjerë shtypës (të tillë si seksualiteti, identiteti gjinor, përkatësia etnike, statusi i migrimit, aftësia e kufizuar, etj.) që çojnë në përvoja unike të dhunës. Duke kuptuar mënyrat e ndryshme në të cilat dhuna ushtrohet dhe përjetohet, një qasje bazuar në ndërsektorialitetin / ndërthurjen, mund të çojë në hartimin dhe zhvillimin e përgjigjeve të përshtatshme specifike për adresimin e rasteve në mënyrën e duhur. Gjatë zbatimit të kësaj strategjie akterët përgjegjës duhet të pranojnë se përvojat e dhunës ndaj grave janë të formuara nga faktorë të tillë si raca, ngjyra, feja, origjina, pasuria, statusi martesor, orientimi seksual, statusi i HIV/AIDS, statusi i emigrantes ose refugjates, mosha, paaftësia, etj., të cilat duhet të merren të gjitha në konsideratë dhe të adresohen në mënyrën e duhur.
- ***Trajtimi i kompensimit të viktimës si një element thelbësor që mundëson drejtësi të plotë dhe rikuperim e riintegrim të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.*** Akterët përgjegjës për zbatimin e kësaj strategjie dhe në mënyrë të veçantë hartuesit e kuadrit ligjor, duhet të duhet të ndërmarrin hapa për të adresuar çështjen e kompensimit të viktimave. Ligjet duhet të lejojnë që dënimet penale të përfshijnë një urdhër kompensimi dhe kthimi nga autori për viktimën ose trashëgimtarët e saj - duke përjashtuar nga këta trashëgimtarë çdo autor ose bashkëpunëtor të krimit ose vrasjes së "nderit". Një kompensim i tillë duhet të mbulojë shpenzimet mjekësore të viktimës, dhimbjen dhe vuajtjen, shpenzimet ligjore, këshillimin, humbjen e të ardhurave dhe shpenzime të ngjashme. Ligjet gjithashtu duhet të shprehin qartë se ndërsa kompensimi është një element ndëshkues për kryerësin në rastet e dhunës ndaj grave, ai nuk zëvendëson dënime të tjera si p.sh. dënimin me burg. Gjithashtu programi i kompensimit duhet të sponsorizohet nga shteti.

IV. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 dhe Plani i saj i Veprimit përbëhet nga katër Objektiva Strategjike të cilët janë zbërthyer më tej në objektiva specifike.

Në përputhje me nenin 4 të Konventës së Stambollit, përkatësisht “masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër”, në zbatimin e të gjitha masave dhe veprimeve të parashikuara në objektivat strategjike e të zbërthyer më pas në objektivat specifike, është ndjekur qasja ndër-sektoriale si dhe vëmendje e veçantë i është dhënë adresimit të diskriminimit të shumëfishtë që pësojnë grupe të veçanta në shoqëri. Si rrjedhojë, theks i është vënë veçanërisht grave, të rejave dhe vajzave, posaçërisht nga zonat rurale, me aftësi të kufizuara e nevoja të veçanta, nga minoritetet etnike, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza-nëna, emigrante dhe azilkërkuese, etj.⁵⁸

Me qëllim matjen e progresit në përmbushjen e objektivave specifike e strategjike, si dhe të misionit që mbart kjo Strategji, do të vlerësohet mundësia e matjes dhe raportimit të këtyre treguesve sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Po kështu, një tregues i rëndësishëm për t’u matur përsa i takon zbatimit me efektivitet të kësaj strategjie është edhe “*Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet*”.

Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish-partner intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas formës së dhunës dhe sipas moshës (Indikatori SGD 5.2.1)

Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Indikatori SGD 5.2.2)

Përqindja e personave viktimë të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Indikatori SGD 11.7.2)

Përqindja e të rejave dhe të rinjve të moshës 18-29 vjeç të cilët përjetuan dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç (Indikatori SGD 16.2.3)

Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse (Indikatori SGD 16.3.1)

⁵⁸ Shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>.

IV.1. OBJEKTIVI STRATEGJIK I

I. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës.⁵⁹

Parandalimi dhe identifikimi janë dy momente shumë të rëndësishme në trajtimin e fenomenit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ndërkohë që identifikimi mundëson trajtimin në kohë dhe me efektivitet të rasteve përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar, parandalimi është kusht jo vetëm që episodet e dhunës së identifikuar të mos përshkallëzohen, por mbi të gjitha që ato të vijjnë duke u pakësuar. Sa më shumë të investohet në parandalim, aq më shumë rezultate do të ketë puna e përbashkët në të ardhmen.

Parandalimi është ngushtësisht i lidhur me edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë. Nëse faktorët që nxitin e përshkallëzojnë dhunën të tillë si paragjykimet, stereotipet gjinore, diskriminimi gjinor e i shumëfishtë, efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore, etj., do të trajtohen që në fëmijërinë e hershme dhe nëse do të investohet vazhdimisht në edukimin e vetëdijesimin e shoqërisë për të mos e toleruar dhunën në familje e dhunën ndaj grave, atëherë nga njëra anë do të kemi rritjen e besimit në institucionet përgjegjëse të cilat e trajtojnë dhunën e identifikuar (pra dhe rritje të numrit të rasteve të identifikuara e denoncuara), ndërsa nga ana tjetër do të kemi zvogëlim të mundësive që dhuna të ri-përsëritet e përshkallëzohet. Pra gradualisht do të shkojmë drejt zvogëlimit të numrit të rasteve të ushtrimit të këtyre formave të dhunës.

Për këtë arsye, në objektivat specifike që zërthejnë objektivin strategjik I, janë parashikuar veprime e masa të lidhura me edukimin dhe vetëdijesimin e shoqërisë për të mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Puna me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile, mediat dhe bizneset është gjithashtu e rëndësishme dhe ndihmon si në identifikimin e rasteve të dhunës, edhe në parandalimin e saj. Njëkohësisht nën këtë objektiv strategjik është parashikuar edhe puna me kryerësit e dhunës, pasi nevoja për trajtimin e tyre është tashmë një domosdoshmëri. Ky trajtim duhet të vlerësohet që të parashikohet të jepet si gjatë periudhës që kryerësit shlyejnë dënimin për veprën penale të shkaktuar, ashtu edhe më pas. Edukimi i brezave të rinj e posaqërisht djemve dhe burrave është i domosdoshëm të fokusohet në përgatitjen e tyre si aleatë të vajzave dhe grave për veprimet kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave dhe për të krijuar kështu brezin e barazisë (“generation equality”).

Objektivat specifike të parashikuar nën Objektivin Strategjik I:

Objektivi specifik I.1	Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që justifikojnë dhunën.
Objektivi specifik I.2	Ndërmarrja e masave edukative dhe arsimore në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën.
Objektivi specifik I.3	Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën.

⁵⁹ Në të gjithë përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje e Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026 si dhe Planin e saj të Veprimit, fjala “dhunë” nënkupton dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.

Objektivi specifik I.4	Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës.
------------------------	---

Për të matur avancimin drejt përmbushjes së objektivave specifike dhe Objektivit Strategjik I “Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit”, janë përcaktuar edhe treguesit si në vijim:

Objektivi strategjik I			
Parandalimi dhe identifikimi i dhunës nëpërmjet edukimit dhe vetëdijesimit			
Treguesit në nivel objektivi strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Përqindja e grave, burrave, vajzave dhe djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme.	Përcaktohet me një studim në vitin 2022	Rritur me 5%	Rritur me 10%
2. Indeksi i sigurisë së grave	Çdo 0.737 në 1 grua ⁶⁰	Çdo 0.85 në 1 grua	Çdo 1 në 1 grua
3. Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet	13 raste të vrasjeve në familje për vitin 2020 ⁶¹	Zvogëluar me 50%	Zvogëluar me 100%
Objektivi specifik I.1: Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që justifikojnë dhunën.			
Treguesit në nivel objektivi specifik I.1:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/raportuara nga pala e tretë	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Rritur me 10%	Rritur me 20%
2. Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Indikator 5.2.2)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Zvogëlohet me 20%
Objektivi specifik I.2: Ndërmarrja e masave edukative dhe arsimore në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën.			
Treguesi në nivel objektivi specifik I.2:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
Numri i sesioneve informuese të zhvilluara për stafin e institucioneve të arsimit parauniversitar mbi shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës.	0 (Udhëzuesi po përgatitet, sesionet do zhvillohen më pas)	60 sesione në 30 komuna	16 sesione në 8 komuna të tjera
Objektivi specifik I.3: Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën.			
Treguesit në nivel objektivi specifik I.3:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026

⁶⁰ Siç paraqitet e matur në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/WPS-Index-2021-Summary.pdf>.

⁶¹ Vlera është caktuar bazuar në dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës. Për më tepër shih tabelat në shtojca.

1. Numri i institucioneve mediatike dhe bizneseve private që mbështeten të miratojnë udhëzime, standarde vetërregulluese e protokolle për të parandaluar diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës.	0	Rritur me 20%	Rritur me 50%
2. Përqindja e personave viktime të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Indikatori SGD 11.7.2)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Zvogëlohet me 20%
Objektivi specifik I.4: Krijimi dhe zbatimi i programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës, bazuar në modelet ekzistuese evropiane.			
Treguesi në nivel objektivi specifik I.4:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
Numri i kryerësve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave që trajtohen në programet psiko-sociale, të ngritura sipas parashikimeve në këtë Strategji.	0	Rritur me 30%	Rritur me 60%

Disa nga **rezultatet e pritshme** nga zbatimi i objektivave specifike nën Objektivin Strategjik I janë:

- Vetëdijesimi i shoqërisë për të mos toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave do të ngritet edhe si rrjedhojë e veprimeve të integruara ndërsektoriale;
- Raportimi i rasteve nga palët e treta do të rritet, siç edhe e parasheh legjislacioni në fuqi;
- Do të mundësohet edhe matja e treguesve të harmonizuar me SDG-të sic janë psh treguesit e SDG 5.2.2. dhe 11.7.2, apo edhe i treguesve të tjerë të cilët maten në nivel ndërkombëtar;
- Programet lëndore të institucioneve arsimore të të gjitha niveleve do të ofrojnë dije për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen dhe në tërësi luftimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- Stafi i institucioneve arsimore para universitare do të jetë më i përgatitur profesionalisht për të identifikuar dhe referuar sipas standardeve rastet e dhunës në familje apo dhunës ndaj grave;
- Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, mediave dhe bizneseve private do të fuqizohet dhe shoqërohet me rezultate pozitive në veprime kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave;
- Kryerësit e dhunës në familje do të trajtohen në aspektin psiko-social në përputhje me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu me rëndësi mbetet edhe investimi në edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues të nxënësve e nxënësve në arsimin para universitar. Janë zhvilluar kurrikulat gjithëpërfshirëse të

edukimit seksual për arsimin para universitar (klasa 1-12) dhe përfshijnë informacione për: rritjen dhe zhvillimin; anatominë dhe fiziologjinë seksuale; riprodhimin, kontracepsionin, shtatzëninë dhe lindjen; HIV dhe SIDA; IST; jetën familjare dhe marrëdhëniet ndërpersonale; kulturën dhe seksualitetin; fuqizimin e të drejtave të njeriut; mosdiskriminimin, barazinë dhe rolet gjinore; sjelljen seksuale; diversitetin seksual; abuzimin seksual; dhunën me bazë gjinore; dhe praktikatat e dëmshme.⁶²

Me zbatimin me sukses të Objektivit Strategjik I pritet që numri i grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve në Republikën e Kosovës, të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme, është rritur si pasojë e veprimeve të ndërmarra për vetëdijesimin dhe edukimin e shoqërisë në këtë drejtim. Po kështu, numri i rasteve të dhunës në familje apo dhunës ndaj grave të cilat përfundojnë në fatalitet, do të reduktohet ndjeshëm si pasojë e vetëdijesimit të shoqërisë dhe shmangies së qëndrimeve justifikuese ndaj dhunës.

IV.2. OBJEKTIVI STRATEGJIK II

II. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare

Qeveria e Kosovës e ka prioritet luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave dhe në këtë kuadër janë ndërmarrë një sërë veprimesh për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave që fokusohen si në identifikimin ashtu edhe në trajtimin, mbështetjen, riintegrimin e fuqizimin e viktimave/të mbijetuarave të dhunës, por edhe në parandalim përmes edukimit e vetëdijesimit të shoqërisë në tërësi. Në zbatim të kësaj Strategjie është planifikuar që të vijohet më tej me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave. Kështu, së pari do të përmirësohet Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (ky proces është në zhvillim e sipër duke pasur parasysh edhe standardet e Konventës së Stambollit, por edhe eksperiencën e deritanishme dhe problematikat apo zbrazëtirat e evidentuara nga zbatimi i tij. Gjithashtu, është parashikuar edhe një analizë ex post e ligjeve aktualisht në fuqi. Këto hapa do të hidhen pas një analize të detajuar të kuadrit ligjor dhe identifikimit të të gjitha akteve ligjore që kanë nevojë të përditësohen e harmonizohen. Përveç kuadrit ligjor janë edhe një sërë politikash të cilat kanë nevojë të rishikohen e përditësohen duke u harmonizuar me standardet ndërkombëtare (si për shembull Procedurat Standarde të Veprimit, standardet e funksionimit të strehimoreve si dhe të qendrave që ofrojnë shërbime të tjera mbështetëse të specializuara, etj.).

Profilizimi i profesionistëve të fushave të ndryshme është gjithashtu domosdoshmëri dhe një hap i rëndësishëm i parashikuar si pjesë e zbatimit të objektivave specifike nën këtë Objektiv Strategjik II. Kjo domosdoshmërisht do të shoqërohet dhe me ndërtimin / fuqizimin e kapaciteteve të këtyre profesionistëve dhe profesionistëve të institucioneve kryesore përgjegjëse e partnere në luftën kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, në përputhje dhe me nenin 15 të Konventës së Stambollit⁶³. Neni 15 e kësaj Konvente, parasheh sa vijon: "Palët sigurojnë ose forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, mbi

⁶² Informacion i dhënë nga UNFPA në kuadër të përgatitjes së këtij dokumenti Strategjik.

⁶³ Shiko: <https://rm.coe.int/168046246b>

parandalimin dhe zbulimin e një shkeljeje të tillë, barazinë midis burrave dhe grave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e parandalimit të viktimizimit dytësor. 2. Palët inkurajojnë që trajnimi i përmendur në paragrafin 1 të përfshijë trajnim për bashkëpunimin e bashkërenduar midis shumë agjencive, për të lejuar një trajtim gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve në rastet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente”.

Në këtë Strategji është parashikuar edhe nevoja për të investuar me burime financiare, njerëzore e infrastrukturore, si dhe bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, me qëllim lehtësimin proceseve të trajtimit të viktimave e menaxhimit të rasteve.

Objektivat specifike të parashikuar nën Objektivin Strategjik II:

Objektivi specifik II.1	Përmirësimi i kornizës ligjore për trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.
Objektivi specifik II.2	Fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Për të matur avancimin drejt përmbushjes së objektivave specifike dhe Objektivit Strategjik II “Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare”, janë përcaktuar edhe treguesit si në vijim:

Objektivi strategjik II			
Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare			
Treguesit në nivel objektiv strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Numri i kallzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur, të pazgjidhura për çdo vit	13 vepra me kryes të rritur dhe 43 vepra me kryes të mitur, për vitin 2020	Zvogëluar me 50%	Zvogëluar me 90%
2. Përqindja e grave të dhunuara nga partneri intim	4% në vitin 2021 ⁶⁴	Zvogëlohet me 10%	Zvogëlohet me 20%
3. Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish-partner intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas formës së dhunës dhe sipas moshës (Indikator i SGD 5.2.1)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Zvogëlohet me 20%
Objektivi specifik II.1: Përmirësimi i kornizës ligjore për trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.			
Treguesi në nivel objektiv specifik II.1:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026

⁶⁴ Sipas matjeve të pasqyruara në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/WPS-Index-2021-Summary.pdf>.

Niveli i reflektimit të kuptimit gjinor të dhunës ndaj grave dhe të të gjitha formave të kësaj dhune, sipas Konventës së Stambollit, në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës	Në kornizën ligjore aktuale mungon kuptimi gjinor i dhunës ndaj grave, veçanërisht jashtë sferës së dhunës në familje ⁶⁵	50% përputhshmëri me Konventën e Stambollit	100% përputhshmëri me Konventën e Stambollit
Objektivi specifik II.2: Fuqizimi i kapaciteteve për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.			
Treguesit në nivel objektivi specifik II.2:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Numri i kurrikulave të formimit të profesionisteve e profesionistëve të përgatitura e zhvilluara	4	8	12
2. Treguesi: Numri i profesionisteve dhe profesionistëve të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës, në mënyrë të përvitshme	Do merren të dhënat për 2020-2021	Rritur me 10%	Rritur me 20%

Disa nga rezultatet e pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën Objektivin Strategjik II janë:

- Miratimi i akteve ligjore dhe politikave për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, do të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës;
- Profesionistët dhe profesionistët e të gjitha insitucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, do të jenë të trajnuar dhe aftësuar;
- Përmirësimi i mënyrës së matjes dhe të dhënave që mblidhen në lidhje me rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhe mundësinë e matjes së treguesve të zhvillimit të qendrueshëm si p.sh. SDG 5.2.1.

Me zbatimin me sukses të objektivit strategjik II pritet që rastet e denoncuar të të gjitha formave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, të hetohen dhe ndëshkohen në përputhje me legjisllacionin në fuqi, me prioritet e përgjegjshmëri institucionale. Zbatimi i këtij legjisllacioni të përmirësuar me efektivitet në praktikë do të sjellë edhe zvogëlimin e numrit të kallzimeve penale me kryerës të rritur dhe të mitur, të pazgjidhura për çdo vit. Kuptohet që paralelisht me ndëshkimin, do të veprojnë edhe programet dhe politikat për rehabilitimin e kryerësve të dhunës, sikurse u cekën në Objektivin Specifik I.4 më sipër.

⁶⁵ Sipas raportit përgatitur nga Rrjeti i Grave Kosovë “Nga ligjet në vepra”, Maj 2021. Shiko: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

IV.3. OBJEKTIVI STRATEGJIK III

III. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave.

Bazuar në ecurinë e deritanishme të punës së institucioneve përgjegjëse dhe partnere në luftën kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe në vijim të rekomandimeve të dala nga zbatimi i Strategjisë së mëparshme Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, vlerësohet i rëndësishëm fuqizimi i mekanizmave si në nivel qendror edhe në nivel lokal.

Në nivelin qendror, Zyra e Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje do të fuqizohet me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore e infrastrukurore, të cilat do të mundësojnë kryerjen e një sërë procesesh si koordinim, monitorim e vlerësim të nismave kundër dhunës, sic parashihet në Konventën e Stambollit si dhe zbatimin e kësaj Strategjie.

Në nivelin lokal, Mekanizmat Koordinues kundër dhunës në familje të ngritur deri tani një pjesë të komunave të Republikës së Kosovës kanë treguar se janë të domosdoshme dhe në harmonizim edhe me qasjen shumë-sektoriale të koordinuar që theksohet në Konventën e Stambollit.

Këta mekanizma kanë nevojë të fuqizohen e të jenë sa më efikasë në punën që kryejnë, ndërkohë që nevojitet shtrirja e tyre në mbarë vendin dhe zgjerimi i fokusit të ndërhyrjes, duke përfshirë edhe dhunën ndaj grave. Puna me marrëveshje, protokolle e procedura të përbashkëta të harmonizuara është gjithashtu domosdoshmëri.

Një vend të rëndësishëm në drejtim të bashkëpunimit dhe koordinimit duhet të zënë organizatat e shoqërisë civile të specializuara në luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Ky bashkëpunim duhet të shtrihet në disa drejtime dhe shoqëria civile duhet të jetë e pranishme që në hartimin, deri në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave publike. Mbledhja dhe përditësimi i të dhënave është një tjetër element i rëndësishëm ku duhet të fokusohen përpjekjet e përbashkëta ndër-institucionale. Konventa e Stambollit në lidhje me të dhënat shprehet qartësisht se nevojiten të dhëna si nga kërkimet dhe hulumtimet, ashtu edhe të dhëna administrative që mbledhen e përditësohen nga institucionet përgjegjëse e partnere. Përmes hulumtimeve është menduar të mbledhen të dhëna sasiore e cilësore mbi perceptimin e publikut për të mos e toleruar dhunën, apo të dhëna në përputhje me treguesit e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve).

Ndërsa në lidhje me të dhënat administrative është parashikuar fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të përmirësuar hedhjen e të dhënave dhe përdorimin në kohë reale të databazës së krijuar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kjo mund të kërkojë edhe koordinim dhe bashkërendim me mënyrën se si institucionet mbledhin e regjistrojnë të dhënat e tyre administrative. Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës është gjithashtu pjesë e veprimeve të parashikuara nën objektivin strategjik III. Këtu janë mbajtur në konsideratë dhe është bërë referencë në dokumente të tjerë në të cilët janë parashikuar veprime të njëjta, sidomos në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. Në këtë rast është cilësuar si në tabelën e Planit të Veprimit edhe me footnote se në cilin dokument është bërë referenca si dhe është treguar kujdes që nëse fondet për zbatimin e një veprimi të caktuar janë parashikuar në dokumentin referent, të mos bëhet kostimi si pjesë e kësaj strategjie.

Objektivat specifike të parashikuar nën Objektivin Strategjik III:

Objektivi specifik III.1	Fuqizimi i grupit koordinues ndërinstitucional në nivel qendror.
Objektivi specifik III.2	Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës.
Objektivi specifik III.3	Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.
Objektivi specifik III.4	Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndër-institucionale për evidentimin e rasteve.
Objektivi specifik III.5	Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës.

Për të matur avancimin drejt përmbushjes së objektivave specifike dhe objektivit strategjik III “Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave”, janë përcaktuar edhe treguesit si në vijim:

Objektivi strategjik III				
Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave.				
Treguesit në nivel objektivi strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024		Synimi 2026
1. Përqindja e institucioneve anëtare të mekanizmave koordinues qendrorë e lokalë të fuqizuar e që zbatojnë në mënyrën e duhur përgjegjësitë e përbashkëta në përputhje me Konventën e Stambollit.	Do përcaktohet në 2022	Rritur	me 50%	Rritur me 80%
2. Përqindja e rasteve të dhunës të raportuara në institucionet përgjegjëse (Indikatori SGD 16.3.1)	Do përcaktohet në 2022	Rritur	me 10%	Rritur me 20%
3. Numri i rasteve të dhunës në familje me vendim përfundimtar gjykatë	Do përcaktohet në 2022	Rritur	me 50%	Rritur me 100%
Objektivi specifik III.1: Fuqizimi i grupit koordinues ndërinstitucional në nivel qendror.				
Treguesi në nivel objektivi specifik III.1:	Vlera bazë	Synimi 2024		Synimi 2026
Linja buxhetore adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatorës Nacionale kundër Dhunës në Familje, për një koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës.	Do përcaktohet në 2022	Rritur	me 15%	Rritur me 30%
Objektivi specifik III.2: Ngritja dhe fuqizimi i mekanizmave koordinues në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës				
Treguesi në nivel objektivi specifik III.2:	Vlera bazë	Synimi 2024		Synimi 2026
Numri i Mekanizmave Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës, të ngritur në mbarë vendin, me koordinatorë/koordinator lokal dhe	20	28		38

mbështetje buxhetore të përcaktuara qartësisht.			
Objektivi specifik III.3: Avancimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe Organizatave të Shoqërisë Civile			
Treguesi në nivel objektivi specifik III.3:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
Përqindja e buxhetit dedikuar OJQ-ve që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, mbrojtjes (duke përfshirë strehimoret) dhe riintegrimin e fuqizimit të viktimave/të mbijetuarave	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10%	Rritur me 30%
Objektivi specifik III.4: Hulumtimi, mbledhja dhe përditësimi i të dhënave ndërinstitucionale për evidentimin e rasteve.			
Treguesit në nivel objektivi specifik III.4:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Databaza me të dhënat për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektoriale të koordinuar, funksionale dhe e përditësuar rregullisht.	Databaza 65% funksionale	Databaza 100% funksionale	Databaza 100% funksionale
2. Përqindja e të rejave dhe të rinjve të moshës 18-29 vjeç të cilët përjetuan dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç (Indikator i SGD 16.2.3)	Do përcaktohet gjatë 2022	Zvogëluar me 10%	Zvogëluar me 20%
Objektivi specifik III.5: Përmirësimi i qasjes në drejtësi të viktimave/të mbijetuarave të dhunës.			
Treguesit në nivel objektivi specifik III.5:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Numri i viktimave / të mbijetuarave të dhunës të cilët përfitojnë ndihmë juridike falas	1803 persona kanë kërkuar ndihmë juridike falas gjatë vitit 2020	Rritur me 40%	Rritur me 70%
2. Numri i grave që kanë qasje në drejtësi⁶⁶	Çdo 1.83 në 4 gra	Çdo 2.5 në 4 gra	Çdo 4 në 4 gra

Disa nga rezultatet e pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën objektivin strategjik III janë:

- Qeveria e Kosovës do t'i dedikojë buxhetin e duhur dhe do të ndajë fonde adekuate për fuqizimin e Zyrës së Koordinatores Nacionale kundër Dhunës në Familje, për të mundësuar koordinim dhe monitorim efikas të veprimeve kundër dhunës;
- Mekanizmat Koordinues lokalë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, do të jenë të ngritur dhe funksionale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me burime njerëzore e financiare adekuate e të qëndrueshme;

⁶⁶ Siç përcaktohet në: <https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/democracy-human-rights-and-governance>

- Policia e Kosovës do të jetë e fuqizuar përmes themelimit të drejtorisë së veçantë në polici në nivel qendror dhe njësi nga niveli rajonal dhe lokal për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Mbështetja logjistike për njësitet e trajtimit të rasteve të dhunës në familje do të mundësojë transportin për viktimat në qasje për shërbime emergjente qofshin ato mjekësore, paraqitje në gjykatë apo shërbime tjera mbështetëse. Do të krijohen fondet emergjente (para të imëta) në Policinë e Kosovës dhe Qendrat për Punë Sociale me qëllim të plotësimit të nevojave emergjente të viktimave gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje gjatë qëndrimit në stacionet policore dhe QPS.
- Organizatat e specializuara të shoqërisë civile që punojnë ngushtësisht në zbatim të Konventës së Stambollit, në drejtim të parandalimit, mbrojtjes dhe riintegritimit e fuqizimit të viktimave/të mbijetuarave, do të mbështeten me burime financiare, ngjashmërisht si edhe OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime të specializuara strehimi;
- Të dhënat për menaxhimin e rasteve dhe të dhënat administrative për rastet e trajtuara në mënyrë shumë-sektorioale të koordinuar, si dhe për rastet që kërkojnë dhe marrin ndihmë juridike falas, do të jenë të përditësuara nga të gjitha institucionet përgjegjëse dhe do të rregjistrohen në databazë në kohë reale;
- Do të përmirësohet mënyra e mbledhjes së të dhënave duke u fokusuar edhe tek tregues që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm (si psh SGD 16.2.3);
- Do të synohet përmirësimi i qasjes në drejtësi të të gjitha grave dhe vajzave dhe matja e këtij përmirësimi me tregues që mblidhen në nivelin ndërkombëtar.

Me zbatimin me sukses të Objektivit Strategjik III pritet që mekanizmat koordinues qendrorë e lokalë të nevojshëm do të jenë ngritur dhe do të funksionojnë në mënyrë efikase. Paralelisht do të jetë mundësuar përmirësimi i koordinimit, si ndërmjet këtyre mekanizmave ashtu edhe me shoqërinë civile në tërësi, ndërkohë që do të avancohet drejt proceseve monitoruese e vlerësuese si për zbatimin e kësaj strategjie kombëtare, ashtu dhe për politikën publike kundër dhunës, në tërësi.

IV.4. OBJEKTIVI STRATEGJIK IV

IV. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mundësuar riintegrimin dhe fuqizimin e viktimave / të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, është një tjetër drejtim i rëndësishëm që përbën dhe shtyllën e katërt të kësaj strategjie kombëtare.

Pas veprimeve të menjëhershme të mbrojtjes dhe sigurisë për rastet e identifikuar apo të denoncuar, nevojitet të hidhen hapa drejt riintegritimit dhe fuqizimit, me qëllim që këto gra dhe vajza por edhe djem dhe burra të cilët kanë përjetuar dhunë, të mund të jetojnë të lirë nga dhuna. Kështu që veprimet e parashikuara nën këtë objektiv strategjik fokusohen kryesisht në

mbështetjen, shtrirjen, përmirësimin apo fuqizimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara, paralelisht me shërbimet e përgjithshme, në përputhje dhe harmonizim edhe me Konventën e Stambollit.

Sipas Konventës, shërbimet mbështetëse të specializuara janë të domosdoshme dhe një shtet duhet të parashikojë të paktën ngritjen dhe funksionimin me efikasitet të këtyre lloj shërbimesh: a) Strehimoret (ku parashikohet strehim i sigurt, i aksesueshëm dhe disponueshëm 24 orë çdo ditë të javës, për të gjitha grupet e grave dhe vajzave apo viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave), b) Linjat telefonike të ndihmës (të cilat duhet të jenë të shtrira në të gjithë vendin, në dispozicion 24 orë çdo ditë të javës, pa pagesë, për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me shërbim që ofrohet të paktën në të dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe idealisht në të gjitha gjuhët, varësisht gjuhës që flet viktimat), c) Mbështetje për viktimat e dhunës seksuale (të tilla si qendra të emergjencës për përdhunimin ose qendra të referimit për viktimat e dhunës seksuale, ku mundësohet ekzaminim mjekësor dhe mjeko-ligjor, si menaxhimi klinik i përdhunimit, sigurimi i kitit të përdhunimit/ kontraceptivëve urgjent dhe PEP Kit, etj., mbështetje për traumën, këshillim, etj.), d) Mbështetje për fëmijën dëshmitar të dhunës (shërbimet mbështetëse duhet të marrin parasysh të drejtat dhe nevojat e fëmijës dëshmitar të dhunës dhe në këto shërbime duhet të ofrohet këshillim psikologjik i përshtatshëm sipas moshës së fëmijëve), e) Mbështetje nëpërmjet ndihmës ligjore (këshillueset për mbrojtje nga dhuna duhet të ndihmojnë dhe/ose mbështesin viktimat gjatë hetimeve dhe procedurave gjyqësore; gjithashtu duhet të parashikohet ofrimi i shërbimeve të duhura mbështetëse për viktimat në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten dhe të merren parasysh), f) Programet për kryerësit (ku parashikohen dy lloje të veçanta të programeve: për kryerësit që ushtrojnë dhunë në familje dhe për abuzuesit seksualë).

Në mënyrën se si janë parashikuar veprimet nën këtë strategji kombëtare, programet për kryerësit janë përfshirë si pjesë e objektivit strategjik I dhe objektivit specifik I.4. Ndërsa të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse të specializuara, përfshirë edhe qendrat e këshillimit për gra dhe vajza, apo edhe për djem dhe burra, strehimoret për rastet e të dhunuarve djem, të rinj dhe burra, apo mundësitë për strehimin e përbashkët të nënës dhe fëmijës së dhunuar djalë të grupmoshës 12 – 18 vjeçare, etj., janë të parashikuara nën këtë Objektiv Strategjik III. Paralelisht janë parashikuar edhe masa dhe veprime të domosdoshme për riintegrimin afatgjatë e të qëndrueshëm të viktimave / të mbijetuarave të dhunës. Vlen të theksohet po ashtu roli i rëndësishëm i organizatave të shoqërisë civile të specializuara që me ekspertizën dhe angazhimin e tyre do t'i kontribuojnë arritjes së këtij objektiv.

Objektivat specifikë të parashikuar nën objektivin strategjik IV:

Objektivi specifik IV.1	Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat nga të gjithë grupet, si dhe fëmijët viktimat dhe dëshmitarë të dhunës.
Objektivi specifik IV.2	Zbatimi i politikave që mundësojnë riintegrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës.

Për të matur avancimin drejt përmbushjes së objektivave specifike dhe objektivit strategjik IV “Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat”, janë përcaktuar edhe treguesit si në vijim:

Objektivi strategjik IV			
Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat			
Treguesit në nivel objektivit strategjik:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
1. Linjë buxhetore përcaktuar sipas një analize dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës.	Buxheti për strehimoret në 2020: 495,000 EUR	Rritur me 5 %	Rritur me 10%
2. Numri i grave që gëzojnë të drejtat pronësore në mënyrë të barabartë si edhe burrat	Çdo 0.62 në 1 grua ⁶⁷	Çdo 0.85 në 1 grua	Çdo 1 në 1 grua
Objektivi specifik IV.1: Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve të specializuara për viktimat/ të mbijetuarat nga të gjithë grupet, si dhe fëmijët viktima dhe dëshmitarë të dhunës			
Treguesi në nivel objektivit specifik IV.1:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
Numri i shërbimeve të specializuara për të mbijetuarat e dhunës, të zgjeruara e fuqizuara, ndarë sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 10 %	Rritur me 30%
Objektivi specifik IV.2: Zbatimi i politikave që mundësojnë riintegrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës			
Treguesi në nivel objektivit specifik IV.2:	Vlera bazë	Synimi 2024	Synimi 2026
Numri i viktimave/ të mbijetuarave të dhunës të riintegruara përmes programeve përkatëse, në nivel qendror e lokal.	Do përcaktohet në 2022	Rritur me 30 %	Rritur me 50%

Disa nga rezultatet e pritshme nga zbatimi i objektivave specifike nën objektivin strategjik IV janë:

- Shërbimet mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat e dhunës do të jenë funksionale, në përputhje dhe me kërkesat/standardet e Konventës së Stambollit;
- Qeveria e Kosovës do të investojë me prioritet në riintegrimin dhe fuqizimin e qëndrueshëm të të mbijetuarave të dhunës, përmes funksionimit me efikasitet të programeve përkatëse;
- Do të përmirësohet edhe gëzimi dhe sigurimi i ushtrimit në mënyrë të barabartë të të drejtave pronësore të grave, si një tjetër mundësi që çon në fuqizimin afatgjatë të tyre.

⁶⁷ Siç përcaktohet në: <https://idea.usaid.gov/cd/kosovo/democracy-human-rights-and-governance>.

Me zbatimin me sukses të objektivit strategjik IV pritet që funksionimi i qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës të mbështetet me buxhetin e nevojshëm nga qeverisja qendrore e lokale (pavarësisht situatave të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore). Po kështu do të mbështetet dhe funksionimi me efikasitet i programeve riintegruese, të cilat mundësojnë fuqizimin e qëndrueshëm të të mbijetuarave të formave të ndryshme të dhunës.

V. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE 2022-2026

Ministria e Drejtësisë / Zyra e Koordinatorës Nacionale kundër dhunës në familje është e mandatuara që të realizojë monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna Ndjaj Grave 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe e Planit të saj të Veprimit.

Synimi kryesor i institucioneve të Republikës së Kosovës, është pa dyshim zbatimi në tërësi i dokumentit strategjik, proces ky që do të paraprihet nga realizimi i aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit nëpër vite. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të synimeve strategjike dhe objektivave të saj.

Për zbatimin e objektivave strategjike, është hartuar Plani i Veprimit tre vjeçar dhe është bërë kostimi i plotë për tri vitet e para. Në këtë plan veprimi përcaktohen objektivat specifike, aktivitetet konkrete karshi institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin e tyre, gjendja ekzistuese, synimi/targeti, burimet financiare, të cilat janë përllogaritur dhe do të përfshihen në kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH) si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në përllogaritjen e nevojave financiare janë marrë në konsideratë edhe projektet me financim nga donatorët, në vijim ose të planifikuara, sipas fushave specifike.

Të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, obligohen të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna Ndjaj Grave 2022-2026 dhe si rrjedhojë edhe të Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë nëpër vite, në përputhje me përgjegjësitë dhe mandatin ligjor të tyre.

Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejnë për të ndjekur ecurinë e zbatimit të strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimit e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara. Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu do të angazhohen dhe luajnë rol të rëndësishëm në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të aktiviteteve dhe masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026.

Monitorimi do të jetë proces kyç për ofrimin e informatave të nevojshme për qëllime llogaridhënieje, ai nuk do të jetë efektiv nëse nuk ndërmerren veprime ndaj asaj që është vlerësuar dhe raportuar. Andaj, çdo 6 muaj dhe fund vit mekanizmat përgjegjës duhet të hartojnë raportin 6 muajor dhe vjetor i cili duhet të përmbajë vlerësimin e aktiviteteve më të suksesshme dhe në përgjithësi përmbushjen e qëllimeve të strategjisë, identifikimin e sfidave dhe vështirësive të hasura gjatë procesit të zbatimit si dhe ofrimin e rekomandimeve konkrete për mënjanimin e pengesave të paraqitura përgjatë procesit të përmbushjes së objektivave

specifike dhe atyre strategjike. Përgjegjësia primare për hartimin e këtij raporti është përcaktuar të jetë e Zyrës së Koordinatorës Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Kjo Zyrë, përmes një formulari që do të përpilohet në muajt e parë të zbatimit të strategjisë, do të kërkojë dhe mbledhë rregullisht të dhëna nga të gjitha institucionet bartëse në realizimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të kësaj Strategjie. Te njejtat do të diskutohen përgjatë takimeve të rregullta të Grupit Koordinues Ndër-Ministror kundër dhunës në familje. Më pas do të bëhet përpunimi i informacionit të mbledhur, si dhe përgatitja e raportit të monitorimit, bazuar në treguesit e përcaktuar si në aktivitetesh, ashtu edhe në nivel objektivash specifike e strategjike. Të dhëna do të kërkojen dhe do të mblidhen edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave si dhe nga organizatat ndërkombëtare e donatorët që kanë ën fokus të punës së tyre këtë çështje.

Monitorimi i zbatimit të dokumentit strategjik dhe efektivitetit të tij janë esenciale:

- (i) për të siguruar që po arrihen qëllimet,
- (ii) për të monitoruar kontributet e investuara dhe aktivitetet,
- (iii) për të siguruar nëse zbatimi po shkon sipas rrjedhës së përcaktuar,
- (iv) për të paralajmëruar institucionet përgjegjëse për problemet/ngecjet ose problemet potenciale para se situata të bëhet kritike,
- (v) për të sugjeruar veprime korigjuese ose për të rishikuar strategjinë në bazë të përvojës së fituar.

Duke monitoruar strategjinë dhe treguesit e performancës, institucionet do të jenë në gjendje të krijojnë një pasqyrë mbi gjendjen, d.m.th. në ç'pikë ndodhet strategjia drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara, nxjerrjes së mësimave, marrjes së masave korigjuese, dhe nëse është e mundur, proceseve rishqyrtuese të saj. Është parë që monitorimi është më i dobishëm kur nxirren mësim nga procesi i zhvilluar, të cilat pastaj shfrytëzohen për procese në të ardhmen. Prandaj, gjatë monitorimit të efektivitetit të zbatimit të strategjisë një gjë e tillë duhet pasur parasysh. Në këtë kuptim, strategjia do të jetë një dokument dinamik, që do t'i përshtatet ndryshimit të objektivave, rrethanave dhe përvojës së fituar.

Ndërsa raportet e monitorimit janë parashikuar të jenë gjashtë mujore dhe vjetore, është e rëndësishme që të kryhet edhe një proces i vlerësimit afatmesëm të zbatimit të strategjisë, përpara vlerësimit përfundimtar të saj. Ky vlerësim që mund të parashikohet të kryhet p.sh. në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, mund të shërbejë për të bërë një riorganizim të parashikimeve në planin e veprimit të Strategjisë varësisht ecurisë afatmesme në zbatim. Kjo do të ndihmonte që të arriheshin edhe qëllimet afatmesme dhe afatgjata të parashikuara në këtë strategji. Përveç vlerësimit afatmesëm, është menduar që të realizohet edhe një proces i vlerësimit në tërësi të përmbushjes së qëllimeve të kësaj strategjie, në vitin e fundit të zbatimit të saj, si parapërgatitje për veprime të mëtejshme përtej vitit 2026.

V. NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË

Plani i Veprimit për zbatimin Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026, ka një kosto totale të zbatimit prej **5,745,570.00 euro** për tri vite të zbatimit (2022-2024).

Pjesa më e madhe e kostos (rreth 00% e buxhetit) do të përdoret për shpenzimet rrjedhëse që lidhen me ngritjen e kapaciteteve, mbështetjen dhe fuqizimin e shërbimeve të specializuara, rregullimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit që ka të bëjë me mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave, koordinimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, etj.

Tabela 1. Paraqet një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas llojeve dhe viteve, ndërsa kjo bazohet në kalkulime të detajuara të shpenzimeve për secilin objektiv të planifikuar.

Zbatimi i planit të veprimit për 3 vitet e para do të kërkojë mjete financiare siç tregohet në tabelën më poshtë në milionë euro (KT- Buxheti i përgjithshëm për Planin e Veprimit, KR- kostot rrjedhëse, K – kapital kapitale, SG – subvencionet dhe grantet).

Tabela 2. Paraqet një përmbledhje të buxhetit për zbatimin e Planit sipas burimeve të financimit.

Tabela 3. Paraqet një shpërndarje të shpenzimeve në kategori të sektorëve dhe sipas viteve për zbatimin e Planit.

Tabela 1. Përmbledhja e buxhetit sipas objektivave dhe viteve

Objektivat Strategjike	2022				2023				2024			
	KT	KR	K	S G	KT	KR	K	S G	KT	KR	K	SG
I. Parandalimi dhe identifikimi i dhunës	224,715.00	202,715.00	22,000.00		146,915.00	131,915.00	15,000.00		136,460.00	121,460.00	15,000.00	
II. Avancimi dhe harmonizimi i politikave publike me standardet ndërkombëtare	123,900.00	53,900.00	70,000.00		105,630.00	30,630.00	75,000.00		112,550.00	57,550.00	55,000.00	
III. Fuqizimi institucional për mbrojtje dhe trajtim të viktimave.	64,800.00	64,800.00	0		38,255.00	38,255.00	0		30,870.00	30,870.00	0	
IV. Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.	1,443,700	738,700	70,500		1,374,700	719,700	65,500		11,129,700	669,700	46,000	

Totali:	1,857,115.00			1,665,500.00			1,409,580.00			
Nën-totali 2022-2024:	4,932,195.00									

Tabela 2. Struktura e shpenzimeve sipas viteve të planifikuara në plan të veprimit dhe burimit të financimit

Vitet	Shpenzime totale		
	BRK	Donatorët	Total:
2022	1,177,037.00	680,078.00	1,857,115.002
2023	1,145,965.00	519,535.00	1,665,500.00
2024	977,657.6	431,922.40	1,409,580.00
Total:	3,300,660.00	1,631,535.00	4,932,195.00

Tabela 3. Shpërndarja e shpenzimeve në kategori sipas sektorëve dhe sipas viteve është si vijon:

Vitet	2022	2023	2024
Paga dhe mëditje			
Mallra dhe Shërbime			
Shpenzime Kapitale	617,000.00	650,000.00	530,000.00
Gjithsej	2,193,800.00	1,791,500.00	1,542,580.00

VI. PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA NDAJ GRAVE 2022 – 2026

Nr.	Objektivat strategjike dhe specifike, treguesit dhe veprimet	Vlera bazë	Objektivi i përkohshëm [2024]	Synimi i vitit të fundit [2026]	Rezultati
I.	Objektivi strategjik: Parandalimi dhe identifikimi i dhunës				
1	Treguesi: Përqindja e grave, burrave, vajzave dhe djemve të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme.	Do përcaktohet me një studim në vitin 2022	Rritur me 5%	Rritur me 10%	Numri i grave, burrave, vajzave dhe djemve në Kosovë, të cilët besojnë se dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave janë të patolerueshme, është rritur si pasojë e veprimeve të ndërmarra për vetëdijesimin e shoqërisë
2	Treguesi: Indeksi i sigurisë së grave	Çdo 0.737 në 1 grua ⁶⁸	Çdo 0.85 në 1 grua	Çdo 1 në 1 grua	Niveli i ndjesisë së sigurisë të gratë rritet në mënyrë të konsiderueshme, përmes të gjitha veprimeve që ndërmerren për t'i mbrojtuar nga çdo formë e dhunës
3	Treguesi: Numri i rasteve të dhunës në familje të cilat përfundojnë në fatalitet	13 raste të vrasjeve në familje për vitin 2020 ⁶⁹	Zvogëluar me 50%	Zvogëluar me 100%	Veprimet e zbatuara me sukses në kuadër të kësaj strategjie do të mundësojnë ndryshimin e mentalitetit dhe do të shmangin çuarjen në fatalitet të rasteve të dhunës ndaj grave në familje.
I.1	Objektivi specifik: Ndryshimi i sjelljeve qëndrimeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që justifikojnë dhunën.				
1	Treguesi: Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuar/raportuara nga pala e tretë	Do përcaktohet gjatë vitit 2022	Rritur me 10%	Rritur me 20%	Vetëdijesimi mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave i përmirësuar vazhdimisht përmes veprimeve të integruara ndërsektoriale, gjë që sjell rritje të

⁶⁸ Siç paraqitet e matur në: <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/10/WPS-Index-2021-Summary.pdf>

⁶⁹ Vlera është caktuar bazuar në dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës. Për më tepër shih tabelat në shtojca.

									rasteve të denoncuar apo raportuara nga palët e treta, siç edhe e parasheh legjislacioni në fuqi
2	Treguesi: Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale nga persona të ndryshëm nga partneri intim në 12 muajt e mëparshëm, ndarë sipas moshës dhe vendit të ndodhjes (Indikator 5.2.2)	Do përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëluar me 10%	Zvogëluar me 20%					Si rrjedhojë e mirëfunksionimit të institucioneve dhe e rritjes së profesionalizimit të ofruesve të shërbimeve, por dhe e rritjes së besimit të komunitetit tek institucionet ligjzbatuese, do të rritet edhe numri i denoncimeve mbi rastet e grave dhe vajzave që janë dhunuar seksualisht dhe që do të kërkojnë mbrojtje nga kjo formë dhune e që do bëjë të bie përqindja e e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart që i nënshtrohen dhunës seksuale.
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			2022	2023	2024				
I.1.1.	Zhvillimi i një analize për të kuptuar perceptimin e përgjithshëm mbi dhunën	2022	20,000.00	X	X	Buxheti i Kosovës Donatorët	MD / Zyra e Koordinatorës	Raporti me të gjeturat dhe rekomandime	Raporti i MICS-it Agjencioni i Statistikave të Kosovës.
I.1.2	Promovimi i modeleve pozitive të “Agjentëve të ndryshimit në komunitet”, të cilët sfidojnë stereotipet gjinore, dhe shprehin mostolerancë ndaj dhunës	2022-2024 (Në vazhdimësi)	9,000.00	9,000.00	9,000.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MD/ Zyra e Koordinatorës , ABGJ, të gjitha Ministrinë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut,	Videomesazhe e postera të personave të dashur për publikun që shërbejnë si modele pozitive dhe nxitje për të mos e pranuar dhe mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7, 12, 12/5 dhe 13, kapitulli IV, nenet 18, 19, kapitulli V, neni 42)

							Organizatrat e shoqërisë civile.		
I.1.3	Sesione informuese dhe mobilizim i liderëve në komunitete si partnerë e bashkëpunëtorë në veprimet kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave	2022-2024 (Në vazhdimësi)	6,000.00	6,000.00	6,000.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MD/ Zyra e Koordinatorës , Bashkësitë fetare, ABGJ, të gjitha ministritë dhe partnerët zhvillimorë, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare	Më shumë liderë në komunitet të informuar, mbi rëndësinë e qëndrimit të tyre kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave Memorandum bashkëpunimi i nënshkruar ndërmjet liderëve të komuniteteve fetare dhe të tjerë dhe Zyrës së Koordinatorës Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, mbi veprime të përbashkëta kundër të gjitha formave të dhunës	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13)
I.1.4.	Aktivitete vetëdijësuese të përmuajshme mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me	2022-2024 (çdo muaj)	3100.00	3100.00	3100.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MD/ Zyra e Koordinatorës , ABGJ,	Të paktën 12 aktivitete vetëdijësuese të realizuara çdo vit	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13)

	fokus të veçantë në grupet e cënueshme të grave dhe vajzave						të gjitha Ministrinë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut, Organizatat e shoqërisë civile.	Më shumë gra dhe vajza nga grupe të cënueshme të informuara mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave	
I.1.5.	Fushata/aktivitete vetëdijesuese të vazhdueshme nga Policia e Kosovës	2022-2024	5,274.00	5,274.00	5,274.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	Policia e Kosovës, Institucionet përgjegjëse lokale, organizatat e shoqërisë civile.	Të paktën tre aktivitete vetëdijesuese të realizuara çdo vit	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13)
I.1.6	Edukimi dhe promovimi i modeleve pozitive të djemve dhe burrave si “Agjentëve të ndryshimit në komunitet”, të cilët sfidojnë stereotipet gjinore, nuk e tolerojnë dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, si dhe nuk pranojnë “kodet e nderit dhe turpit”, që nxitin veprime të	2022-2024 (Në vazhdimësi)	11,200.00	11,200.00	11,200.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MD/ Zyra e Koordinatorës , ABGJ, të gjitha Ministrinë dhe Partnerët Strategjikë, Institucionet e të drejtave të njeriut, Organizatat e shoqërisë civile.	Videomesazhe e postera të personave të dashur për publikun që shërbejnë si modele pozitive dhe nxitje për të mos e pranuar dhe mos e toleruar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Më shumë burra dhe djem aleatë të grave dhe vajzave në	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 7, 12, 12/5 dhe 13, kapitulli IV, nenet 18, 19, kapitulli V, neni 42)

	dhunshme, deri në fatalitet.							luftën kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.	
I.1.7	Fushata e përvitshme e 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje (25 nëntor – 10 dhjetor)	2022-2024 (1 herë në vit)	19,716.00	19,716.00	19,716.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MD/ Zyra e Koordinatorës ABGJ, të gjitha ministrinë dhe partnerët zhvillimorë, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ.	1 Fushatë ndërgjegjësimi e koordinuar ndërmjet institucioneve , partnerëve e OJQ-ve, me kohëzgjatje 16 ditore, e realizuar çdo vit. Bashkërendimi i mesazheve dhe aktiviteteve për të maksimizuar ndikimin.	Konventa e Stambollit (kapitulli III, nenet 12 dhe 13)
I.1.8.	Pilotimi i programeve/kurseve të këshillimit paramartesor, ku ofrohet informacion i detyrueshëm mbi legjislaconin në fuqi për mbrojtjen e familjes nga dhuna, të drejtat martesore e pronësore, etj.	2024	X	X	1,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MAPL Komuna/Zyra t e Gjendjes Civile, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ,	Të reja e të rinj që vendosin të krijojnë familje, janë të informuar mbi ligjin në mbrojtje të familjes dhe format e ndryshme të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave	Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV)

I.1.9.	Vlerësimi i efikasitetit të programeve/ kurseve të pilotuara të këshillimit paramartesor, dhe krijimi i udhëzuesit për shtrirjen e tyre në mbarë Kosovën	2024-2025	X	X	3,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MAPL Komuna/Zyra t e Gjendjes Civile, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ	Raporti i përgatitur mbi vlerësimin e efikasitetit të programeve/qendrave të tilla me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Udhëzuesi i përpiluar për shtrirjen e këtyre programeve/kurseve në mbarë vendin, bazuar mbi këtë vlerësim.	Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV)
I.1.10.	Shtimi i programit të këshillimit për prindërimin pozitiv pranë qendrave të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe familjen, ose pranë qendrave për punë sociale	2022-2024	5,850.00	5,850.00	5,850.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MSH/ Këshillimoret apo Konsultaret e nënave dhe fëmijëve, MFPT/ QPS, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, Komunitat, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ,	Moduli mbi prindërimin pozitiv i zhvilluar dhe i gatshëm për t'u aplikuar me prindër (nëna e baballarë) Profesioniste e profesionistë të trajnuar për ta aplikuar këtë modul	Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV) Kodi i Familjes

							institucionet ndërkombëtare		
I.1.1 1.	Vlerësimi i efikasitetit të programit të këshillimit për prindërimin pozitiv pranë qendrave të shërbimeve shëndetësore për gratë dhe familjen, ose pranë qendrave për punë sociale dhe përgatitja e udhëzuesit për përhapjen e tyre në mbarë Kosovën.	2025-2026	X	X	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	Ministria e Shëndetësisë/ Këshillimoret apo Konsultaret e nënave dhe fëmijëve, MFPT/ QPS, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, Komunitat, institucionet e të drejtave të njeriut, OJQ, institucionet ndërkombëtare	Raporti i përgatitur mbi vlerësimin e efikasitetit të programeve të tilla me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.	Konventa e Stambollit (kapitulli III dhe IV)
I.1.1 2	Fushatë për ndërgjegjësimin e prindërve për parandalimin e martesave të hershme	2022 T4-2024	2400.00	2,400.00	2400.00	Nuk ka nevojë për llogaritje të kostove shtesë ⁷⁰	MASHT, DKA, QPS, OJQ	2 fushata të realizuara në vit	Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020 –

⁷⁰ Ky aktivitet është planifikuar në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024 dhe bëhet fjalë pikërisht për aktivitetin II.1.14 të këtij dokumenti. Për sa kohë që kosto për këtë aktivitet është llogaritur në dokumentin e referencës, nuk ka nevojë të përllogaritet edhe kosto shtesë në këtë Strategji. Llogaritjet për kosto shtesë të bëhen vetëm nëse mungon kosto për vitin 2024 në dokumentin e referencës.

									2024 (aktiviteti II.1.14)
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.1:			82,540.00	62,540.00	67,840.00				
<i>Nga të cilat kapitale:</i>			0	0	0				
<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>			82,540.00	62,540.00	67,840.00				
I.2	Objektivi specifik: Ndërmarrja e masave edukative dhe arsimore në të gjitha nivelet për të parandaluar dhunën								
1	Treguesi: Numri i sesioneve informuese të zhvilluara për stafin e institucioneve të arsimit para universitar mbi shenjat identifikuese, parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës	0 (udhëzuesi po përgatitet, sesionet do zhvillohen më pas)	60 sesione në 30 komuna	16 sesione në 8 komuna të tjera	Stafi i institucioneve të arsimit para universitar i trajnuar dhe aftësuar të identifikojë dhunën si dhe i mirë informuar jo vetëm për mënyrën e referimit të rasteve të tilla të identifikuar, por edhe për të ndërhyrë me efektivitet në parandalimin në tërësi.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente
			2022	2023	2024				
I.2.1.	Hulumtim gjithëpërfshirës mbi aspektet e parandalimit të dhunës në familje nëpërmjet arsimit parauniversitar dhe universitar	2022	20,000.00	X	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI	MASHTI Institutet Partnerët	Raporti me rekomandime	Kurrikulat bërthamë të arsimit parauniversitar/ programet lëndore

									Kurrikulat universitar e/ silabuset lëndore Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15)
I.2.2.	Sesione informuese mbi dhunën me zyrtare/zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, drejtore/drejtorë shkollash, psikologe/psikologë shkollorë dhe njësi akademike.	2022-2024	2,900.00	2,900.00	2,900.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI	MASHTI, DKA shkollat, Njësitë akademike Qendra universitare për të drejtat e njeriut, partnerë të tjerë.	Më shumë zyrtare /zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, drejtore/ drejtorë shkollash, psikologe/psikologë shkollorë të informuar mbi dhunën në familje e dhunën ndaj grave dhe rolin e tyre	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15)
I.2.3	Adresimi dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dala nga hulumtimi gjithëpërfshirës	2023-2024	X	3,300.00	3,300.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI	MASHTI	Programe mësimore dhe materiale shtesë që ndikojnë në parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.	Politikat arsimore parauniversitare dhe universitare
I.2.4	Përgatitja e një udhëzuesi për stafin e institucioneve të	2022-2023	2,500.00	2,500.00	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	MASHTI	Udhëzuesi i përgatitur në harmoni me	Konventa e Stambollit (kapitulli

	arsimit parauniversitar në lidhje me shenjat identifikuese të predispozitave të dhunës në familje të fëmijët në shkolla, me qëllim parandalimi dhe referimi në instancat përgjegjëse.					MASHTI		standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira	III nenet 12,13,14 dhe 15)
I.2.5	Përgatitja dhe zhvillimi i një programi trajnimi për koordinatorë/koordinat orë të cilësisë dhe psikologe/psikologë shkollorë mbi parandalimin, identifikimin, trajtimin dhe referimin e incidenteve të ngacmimit seksual në shkollë, si dhe të dhunës në familje e dhunës ndaj grave, në instancat përgjegjëse	2022-2024	3,500.00	3,500.00	3,500.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës MASHTI	MASHTI Partnerët	2 sesione për pjesëmarrës nga 10 komuna në vit/ gjithsej 30 komuna për 3 vite Më shumë koordinatorë /koordinatorë të cilësisë dhe psikologe/psikologë shkollorë të informuar dhe të gatshëm të parandalojnë, identifikojnë, trajtojnë e referojnë incidentet e ngacmimit seksual në shkollë dhe të formave të tjera të dhunës në instancat përgjegjëse	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13,14 dhe 15)

I.2.6	Hulumtim gjithëpërfshirës lidhur me angazhimin e psikologeve në shkollë dhe identifikimi i nevojave për secilin institucion.	2022	10,000.00	X	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	MASHTI	Raporti i hulumtimit i realizuar dhe u publikuar së bashku me rekomandimet e ofruara.	Legjislacioni mbi arsimin Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 14)
I.2.7.	Zhvillimi dhe shpërndarja e një informatori për rolin e sektorit të arsimit në zbatimin e Konventës së Stambollit	Tetor 2022	11,750.00	X	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës Donatorët	MASHTI, OSBE Këshilli i Evropës	Informatori i finalizuar dhe i shpërndarë në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë Një botim i ri që detajon kërkesat e nenit 14 të Konventës së Stambollit pritet të jetë gati deri në vitin 2022, me mbështetjen e KiE	Konventa e Stambollit (neni 14) Kushtetuta e Republikës së Kosovës
I.2.8.	Sesione informuese me Këshillat e prindërve (nëna dhe baballarë) dhe nxënësve e nxënësve lidhur me barazinë e vajzave dhe djemve dhe pasojat e dhunës në familje	2026	X	X	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	MASHTI, Institucionet e Arsimit Parauniversitar	Sesione informuese të organizuara rregullisht në mënyrë të përvishme Më shumë prindër (nëna dhe baballarë) si dhe më shumë nxënës e nxënës të informuar mbi	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13, 14)

								barazinë e vajzave dhe djemve dhe pasojat e dhunës në familje	
I.2.9.	Edukimi i bashkëmoshatarëve, vajza dhe djem (peer education) për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkolla, si dhe për të mbajtur qëndrim kritik ndaj portretizimit negativ dhe seksist të imazhit të grave dhe vajzave në fusha të ndryshme të jetës.	2022-2026	1,650.00	1,650.00	1,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	MASHTI, Institucionet e Arsimit Parauniversitar	Programe të edukimit të vajzave dhe djemve për parandalimin dhe identifikimin e ngacmimit seksual në shkolla, si dhe për të luftuar portretizimin negativ dhe seksist të grave dhe vajzave, të organizuara në mënyrë të përvitshme. Duke ofruar trajnim për DKA.	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 12,13, 14)
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik I.2:</i>		52,300.00	13,850.00	11,350.00				
	<i>Nga të cilat kapitale:</i>		0	0	0				
	<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>		52,300.00	13,850.00	11,350.00				
I.3.	Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet qeverisë, medias dhe sektorit privat për promovimin e masave për të parandaluar dhe luftuar dhunën								

1	Treguesi: Numri i institucioneve mediatike dhe bizneseve private që mbështeten të miratojnë udhëzime, standarde vetërregulluese e protokolle për të parandaluar diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës.	0	Rritur me 20%	Rritur me 50%	Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, mediave dhe bizneseve private është fuqizuar dhe shoqërohet me rezultate pozitive në veprime kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave. Përgatitja e mjeteve vetërregulluese (protokolle, udhëzime, standarde) për të parandaluar diskriminimin, dhunën, ngacmimin seksual dhe përndjekjen në vendin e punës, në institucionet mediatike e bizneset private, bëhet me nxitjen dhe mbështetjen nga shteti.				
2	Treguesi: Përqindja e personave viktimë të ngacmimit fizik ose seksual, sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendit të ndodhjes, në 12 muajt e mëparshëm (Indikatori SGD 11.7.2)	Përcaktohet gjatë vitit 2022	Zvogëlohet me 10%	Zvogëlohet me 20%	Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës institucionale dhe kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve, si dhe për shkak të rritjes së besimit në institucionet ligjzbatuese, do të rritet edhe numri i denoncimeve mbi rastet e ngacmimit fizik apo seksual në ambiente të ndryshme, përfshirë dhe në botën e punës, andaj përqindja e personave viktimë të ngacmimit fizik ose seksual do bie.				
Nr.	Veprimi	Afati i fundit	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referencat në dokumente
			2022	2023	2024				
I.3.1	Inkurajimi i mediave për të vendosur udhëzime dhe standarde vetërregulluese për të rritur respektin për dinjitetin e grave, në mënyrë që të ndihmojnë në	2022-2023	2,655.00	2,655.00	X	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale,	Mediat inkurajohen dhe mbështeten të vendosin dhe aplikojnë udhëzime dhe standarde vetërregulluese që shmangin diskriminimin dhe dhunën ndaj grave.	Konventa e Stambollit (kapitulli III neni 17)

	ndërtimin e roleve pozitive gjinore dhe të parandalojnë dhunën kundër grave.						OJQ		
I.3.2	Edukimi i profesionisteve dhe profesionistëve të medias për të trajtuar me më shumë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm çështjet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.	2022-2024	1,650.00	1,650.00	1,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/ZK OJQ	Më shumë profesioniste dhe profesionistë të medias vizive e të shkruar, të cilat/cilët trajtojnë me përgjegjshmëri dhe i kushtojnë vëmendjen e duhur dhunës në familje e dhunës ndaj grave	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17)
I.3.3	Promovimi dhe nxitja e rritjes së numrit të grave profesioniste të medias (gazetare, drejtuese, analiste, etj.) si dhe aftësimi i tyre për qasje, përgatitje e menaxhim të informacionit mediatik nëpërmjet teknologjisë.	2022-2026	1,650.00	1,650.00	1,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i Gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ	Më shumë profesioniste gra në fushën mediatike Gratë në media të aftësuara për të përdorur teknologjinë në menaxhimin e informacionit mediatik	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17)

I.3.4	Nxitja e përdorimit të gjuhës jo-seksiste dhe shmangia e reklamave, apo materialeve audiovizive e të shkruara me përmbajtje seksiste dhe qëndrime favorizuese ndaj dhunës e diskriminimit, në institucionet mediatike publike e private	2022-2026	3,000.00	3,000.00	3,000.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM, ABGJ, Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Fakulteti i Gazetarisë, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ	Emisionet televizive, spotet, reklamat dhe shkrimet në mediat publike e private përdorin gjuhë jo-seksiste, jo-diskriminuese e jo-tolerante ndaj dhunës ndaj grave e dhunës në familje	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17)
I.3.5	Përgatitja dhe zbatimi i politikave të qarta dhe mekanizmave funksionalë të ankesave që ndalojnë materialet diskriminuese, me përmbajtje seksiste, apo që favorizojnë dhunën në familje dhe efektet e dëmshme të disa praktikave tradicionale ose zakonore, në median audiovizive e të shkruar	2022-2026	3,250.00	3,250.00	3,250.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, OJQ	Mekanizmi i ankesave dhe politikave kufizuese të qarta dhe aplikueshme në median publike e private	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17)

I.3.6	Bashkëpunimi me mediat dhe kompanitë e informacionit e teknologjisë për të shmangur dhunën, ngacmimin seksual apo përndjekjen e grave dhe vajzave nëpërmjet medias sociale e internetit	2022-2026	420.00	420.00	420.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, Mediat, Kompanitë ICT, Unioni i Gazetarëve, ABGJ, OJQ	Vajzat dhe gratë janë më të sigurta dhe mbrohen nga format e dhunës që mund të pësojnë gjatë përdorimit të internetit dhe mediave sociale	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17, kapitulli IV dhe V)
I.3.7	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e faqeve të ndryshme të internetit, për të siguruar informacion për fëmijët dhe prindërit për përdorimin e sigurt të internetit, mediave sociale dhe komunikimeve elektronike	2022-2026	1,800.00	1800.00	1,800.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	ABGJ, Mediat, Kompanitë ICT, Institucionet e Arsimit Parauniversitar MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, OJQ	Fëmijët dhe prindërit më të aftësuar për të lundruar të sigurt në internet Faqe të caktuara të nevojshme për përdorim nga fëmijët dhe prindërit, të pajisura me kode të sigurisë dhe filtra kontrolli Një manual për shmangien e dhunës dhe lundrimin e sigurt në internet e mediat sociale, i përgatitur dhe në dispozicion të prindërve dhe fëmijëve	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17, kapitulli IV dhe V)

I.3.8	Inkurajimi i mediave të raportojnë në mënyrën e duhur dhe analizojnë dhunën në familje e dhunën ndaj grave duke reaguar me profesionalizëm dhe duke respektuar parimet e etikës dhe mbrojtjes së të dhënave personale	2023-2026	X	1,650.00	1,650.00	Buxheti i Qeverisë së Kosovës	KPM ABGJ Mediat, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Unioni i Gazetarëve, MD/Zyra e Koordinatorës Nacionale, ABGJ, OJQ	Një manual mbi raportimin dhe analizën e dhunës në familje e dhunës ndaj grave nga mediat audiovizive e të shkruara, i përgatitur dhe në dispozicion të profesionistëve e profesionistëve për zbatim Media e përfshirë aktivisht dhe pozitivisht në raportimin dhe vetëdijesimin mbi dhunën në familje e dhunën ndaj grave	Konventa e Stambollit (kapitulli III nenet 15, 17)
